



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Sudski Savet Kosova - Kosovo Judicial Council

RAPORTI VJETOR

2020



© Këshilli Gjyqësor i Kosovës 2020

Publikuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Fjalë hyrëse nga Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës

Kam kënaqësinë të prezantoj raportin vjetor të punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), për vitin 2020. Ky viti do të mbahet në mend për shkak të shpalljes së pandemisë globale nga përhapja e virusit COVID-19, i cili është vdekjeprurës dhe pengoj punën në mbarë botën, duke rezultuar me efekte afatgjate në ekonominë botërore si dhe duke dëmtuar të gjithë sektorët e shoqërisë. Mirëpo, dëmi më i madh është në humbjen e jetës së njerëzve. Ne gjatë këtij viti si gjyqësor humbëm edhe kolegë tanë nga ky virus.

Përveç humbjeve njerëzore, pandemia pengoj edhe vështirësoj punën në sistemin gjyqësor. Përkundër vështirësive dhe sfidave me të cilat u ballafaquam, ne si gjyqësor arritëm që ta mbajmë funksional sistemin gjyqësor duke arritur që të përmirësojmë transparencën, llogaridhënien dhe efikasitetin e gjyqësorit si dhe ndërmorëm një sërë veprimesh për të mbështetur punën e gjykatave, duke hartuar plane emergjente, udhëzime, rregullore, kemi shtuar aktivitetet rreth rekrutimit, etj.

Për të tejkaluar sfidat rreth pandemisë gjyqësori filloi të pilotojë edhe punën online, apo përmes internetit. Kështu, shumë takime të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Komisioneve të tij, si dhe takimet e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave janë mbajtur online. Gjithashtu, gjykatat kanë filluar t'i mbajnë seancat online duke ju dhënë mundësi qytetarëve që t'i realizojnë të drejtat e tyre përkundër pandemisë. Gjykatat kanë vazhduar të zgjedhin lëndët duke respektuar afatet ligjore për shqyrtimin e lëndëve, dhe po ashtu të evitojmë shtyrjen e seancave dhe grumbullimin e lëndëve.

Prandaj, do të doja që t'i falënderoj të gjithë stafin e gjyqësorit që pa marrë parasysh vështirësive dhe rrezikut për shëndetin e tyre nuk ndaluan punën dhe vazhduan të jenë në shërbim të gjyqësorit si çdo herë tjetër.

Skender Çoçaj

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

LISTA E SHKURTESAVE

KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
SKGJK	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
NIGJ	Njësia e Inspektimit Gjyqësor
GJS	Gjykata Supreme
GJA	Gjykata e Apelit
GJTH	Gjykata Themelore
DAP	Departamenti i Administratës Përgjithshme
TIK	Teknologji Informative dhe Komunikim
KE	Komisioni Evropian
MD	Ministria e Drejtësisë
PFSD	Programi i Fuqizimit të Sistemit të Drejtësisë
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave

PËRMBAJTJA

1.0 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
2.0 INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR KËSHILLIN	13
2.1 Misioni	13
2.2 Vizioni	13
2.3 Roli dhe kompetencat e Këshillit	14
2.4 Përbërja e Këshillit	14
3.0 AKTIVITETET E KËSHILLIT	15
3.1 Komisionet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës	16
3.1.1 Komisioni për Çështje Normative	17
3.1.2 Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel	18
3.1.3 Komisioni për Administrimin e Gjykatave	18
3.1.4 Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve	20
3.1.5 Komisioni për Trajnime	21
3.1.6 Komisioni për Kompensimin e Dëmit për personat e Dënuar ose Arrestuar pa arsye	22
3.1.7 Procedura Disiplinore	22
3.2 Aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës	24
3.2.1 Takimet me partnerë ndërkombëtarë	24
3.2.2 Pjesëmarrja e Kryesuesit në konferenca, forume dhe tryeza	24
3.3 Menaxhimi i aktiviteteve në Këshill dhe Gjykata gjatë Pandemisë COVID-19	25
4.0 AKTIVITETET E SEKRETARIATIT TË KËSHILLIT	27
4.1 Zyra e Drejtorit	28
4.1.1 Departamenti i Administratës së Përgjithshme	28
4.1.2 Departamenti Ligjor	32
4.1.3 Departamenti për Buxhet dhe Financa	33
4.1.4 Departamenti i Statistikës	35
4.1.5 Departamenti i Logjistikës	37
4.1.6 Departamenti i Auditimit të Brendshëm	39
4.1.7 Zyra për Teknologji Informative dhe Komunikim	40
4.1.8 Zyra e Prokurimit	43
4.1.9 Zyra për Evidencë Penale	45
4.1.10 Integrimi Evropian	48
4.1.11 Zyra për Mbështetje dhe Përkthime	49
4.1.12 Komunikimi me Publikun	50
4.1.13 Certifikuesi	51
5.0 PANELI I LIRIMIT ME KUSHT	52
6.0 NJËSIA E INSPEKTIMIT GJYQËSOR	54

7.0 VLERËSIMI DHE VERIFIKIMI I GJYQTARËVE	56
8.0 BUXHETI I KËSHILLIT GJYQËSOR	66
8.1 Buxheti, shpenzimet dhe të hyrat gjyqësore	66
8.2 Ndryshimet buxhetore janar - dhjetor 2020	66
8.3 Buxheti dhe shpenzimet 2020	68
9.0 ANALIZA E STATISTIKAVE VJETORE TË KGJK-SË 2020	76
10.0 BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL I KËSHILLIT	120
11.0 SFIDAT	122
12.0 ANEKS - RAPORTI I RREGULLT STATISTIKOR I GJYKATAVE	

I.0 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK), prezanton raportin e punës për vitin 2020, ku janë paraqitur të arriturat dhe aktivitetet e KGjK-së dhe gjykatave në kudër të realizimit të mandatit të tyre kushtetues dhe ligjor.

Viti 2020 ishte një ndër vitet më sfiduese në dekadat e fundit dhe do të mbahet mend si vit i paraqitjes së pandemisë globale COVID-19. Në fillim të marsit të vitit 2020, u paralizua puna e të gjitha institucioneve shtetërore, edukative dhe atyre të sistemit të drejtësisë si dhe u ndalua puna e bizneseve private. Masat e rrepta emergjente ndërprejnë punën e rregullt të gjyqësorit dhe gjykatave përgjatë tre (3) muajve, prej muajit mars gjer në fund të majit, ku ofruan vetëm shërbime emergjente duke i trajtuar lëndët e caktuara. Mirëpo, është e vlefshme të theksohet se përkundër të gjitha sfidave me të cilat u ballafaqua gjyqësori, ai arriti të tregojë qëndrueshmëri dhe rezultate objektive, duke siguruar funksionimin e aktiviteteve dhe punës në rrethana të jashtëzakonshme, duke i kthyer sfidat në mundësi për zhvillim të mëtejshëm, si për shembull avancimi i përdorimit të teknologjisë informative, mbajtjen e seancave dhe takimeve përmes platformave të internetit, aplikimin e teknologjisë informative për komunikim, etj.

Këshilli, gjithashtu shënoi rezultate të dukshme në zhvillimin e politikave të nevojshme për të mundësuar gjykatave funksionim të rregullt dhe për të avancuar rregullativën ligjore duke harmonizuar atë me Ligjin mbi Gjykata dhe Ligjin mbi Këshillin Gjyqësor; ka përmirësuar efikasitetin e gjyqësorit, duke zgjidhur më shumë lëndë se sa që janë pranuar; përmirësuar transparencën e gjyqësorit dhe informuar opinionin publik lidhur me aktivitetet e gjyqësorit; forcuar në vazhdimësi mekanizmat e llogaridhënies si atë të disiplinës dhe vlerësimit të performancës; rekrutimi i gjyqtarëve të ri; si dhe janë marrë një sërë vendimesh dhe aprovuar praktikave më të mira ndërkombëtare për zgjedhjen e lëndëve.

Përveç këtyre të arriturave, të realizuara gjatë një viti mjaft sfidues, Këshilli ka hartuar Planin Strategjik tre (3) vjeçar si dhe planin një (1) vjeçar të punës për realizimin e objektivave të parapara

në Strategji, ka hartuar dhe aprovuar Planin Emergjent për Menaxhimin e Krizave si dhe në vazhdimësi ka bashkëpunuar me Ministrinë e Drejtësisë dhe partnerët ndërkombëtar në avancimin e reformave për të forcuar sundimin e ligjit në Kosovë, të iniciuara nga Ministria e Drejtësisë.

Të arriturat kryesore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë vitit 2020 përfshijnë:

- Hartimin dhe aprovimin e Planit Strategjik tre (3) vjeçar 2020-2023. Strategjia e mëhershme 2014 - 2019 skadoi në fund të vitit 2019, dhe pak para skadimit të saj, Këshilli inicioj procedurën për hartimin e Strategjisë së re. Procesi i hartimit ishte gjithëpërfshirës duke kyçur në proces të gjithë anëtarët e Këshillit, kryetarët e Gjykatave dhe përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtar. Plani Strategjik, mishëron synimet ambicioze reformuese të Këshillit për të përmirësuar efikasitetin, performancën, transparencën dhe llogaridhënien. Plani bazohet në pesë (5) shtylla kyçe; përfshirë: (i) Besimin dhe besueshmërinë e publikut; (ii) Administrimin efektiv dhe efikas të drejtësisë; (iii) Profesionalizimin dhe kompetencën; (iv) Transparencën dhe llogaridhënien; dhe (v) Qasjen në drejtësi.
- Pas miratimit të Planit Strategjik, Këshilli dhe të gjitha organet e tij hartuan planet vjetore të veprimit, duke definuar në detaje aktivitete e nevojshme për realizimin e objektivave të parapara në Strategji. Plani një (1) vjeçar u miratua në fillim të vitit 2020 dhe janë përcaktuar të gjitha aktivitetet për t'i arritur synimet strategjike. Këshilli realizoi shumicën e aktiviteteve të parapara me një ngecje të ndjeshme për shkak të pandemisë.
- Pas ballafaqimit me pandeminë COVID-19, Këshilli më ndihmën e USAID/Programi për Fuqizimin e Sektorit të Drejtësisë hartoi Planin Emergjent për Menaxhimin e Krizave. Plani synon që të sigurojë vazhdimin e funksionimit të institucioneve gjyqësore në rrethanat ekzistuese, duke përfshirë masat e rrepta të emergjencës apo mbylljes së plotë, relaksimim e masave, apo rikthimin eventual të tyre. Plani, gjithashtu parasheh funksionimin emergjent të gjykatave gjatë mbylljes totale, duke trajtuar të gjitha rastet emergjente në kohë të duhur.

- Për të mundësuar vazhdimin e punës së gjyqësorit pas relaksimit të pjeshëm të masave, gjykatat filluan me mbajtjen e seancave përmes platformave të internetit, duke iu mundësuar palëve të marrin pjesë në seanca nga zyrat, apo shtëpitë e tyre. Njëkohësisht, Këshilli gjatë pandemisë ka organizuar takimet nëpërmjet platformave elektronike, duke i respektuar instruksionet e organeve të shëndetit publik.
- Përkundër pandemisë, gjykatat themelore treguan performancë të mirë duke zgjidhur më shumë lëndë në krahasim me vitin 2019, edhe pse këto gjykata pranuan më shumë lëndë në departamentin e krimeve të rënda dhe në atë civil, ato arritën të zgjidhin më shumë lëndë sesa në vitin 2019. Megjithatë, numri i përgjithshëm i lëndëve në këto dy departamente ka shënuar rritje për shkak se pranuan shumë më shumë lëndë sesa në vitin 2019. Përderisa, produktiviteti i departamentit të përgjithshëm penal në të gjitha gjykatat themelore ka shënuar një ngritje për shkak se gjykatat zgjidhen më shumë lëndë sesa pranuan. Kjo për shkak se gjyqtarët zgjidhen më shumë lëndë sesa që pranuan në vitin 2019. Përderisa, departamentet për kundërvajtje zgjidhen më pak lëndë sesa që zgjidhën në vitin 2019.
- Produktiviteti ka shënuar një rënie të lehtë në departamentin ekonomik të Gjykatës Themelore të Prishtinës. Ky departament, zgjidhi më pak lëndë në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019, dhe shkalla e produktivitetit apo shkalla e spastrimit të lëndëve i shënoi një rënie prej 86% në vitin 2019, në 79% në vitin 2020. Përderisa, departamenti administrativ ngriti produktivitetin e tij, duke zgjidhur më shumë lëndë se sa që pranoi, duke ngritur shkallën e spastrimit të lëndëve nga 93% në 102%.
- Gjykata e Apelit, gjithashtu në përgjithësi punoi me një efikasitet të mirë. Mirëpo, efikasiteti varion ndërmjet departamenteve të tij. Shkallë të lartë të efikasitetit, respektivisht të shkallës së spastrimit të lëndëve shënuan departamentet për lëndët civile dhe ai ekonomik. Përderisa, shkalla e efikasitetit shënoi një rënie për shkak të pandemisë në departamentin penal, apo prej 94% në vitin 2019, në 91% në vitin 2020. Gjendja është e ngjashme në departamentin e Krimeve të Rënda nga 99% në 95%, ai administrativë nga 80 në 78%, dhe Departamenti i Kundërvajtjes nga 112% në 95%. Është e qartë se pandemia globale afektoi lehtë punën e Gjykatës së Apelit.

Detajet lidhur me performancën e gjykatave gjenden në shtojcën e raportit të hartuar në bashkëpunim me Këshillin e Evropës.

- Për më tepër, Këshilli gjatë vitit 2020 forcoi rregullativen ligjore me qëllim të forcimit të kornizës së llogaridhënies dhe administrimit efikas të gjyqësorit. Duke parë zbrazëtirat ligjore në vlerësim të performancës, Këshilli inicioj ndryshimin e rregullativës ligjore për vlerësim të performancës së gjyqtarëve, për të përforcuar organizimin dhe funksionimin e gjykatave si dhe të Këshillit. Më tej, u hartuan dhe miratuan rregulloret për organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e Këshillit dhe atë të gjykatave, si dhe rregullore për organizimin e Njësisë së Inspektimit Gjyqësor.
- Këshilli, hartoi dhe aprovoi një sërë vendimesh dhe praktikash të mira ndërkombëtare për të përmirësuar administrimin e gjykatave, përfshirë shqyrtimin e hershëm të lëndëve civile, mbajtjen e seancave përmes platformave të ndryshme, përmes internetit, etj.
- Gjatë vitit 2020, Këshilli përfundoi procesin e rekrutimit të njëzet e shtatë (27) gjyqtarëve, prej të cilëve me njëzet e katër (24) u dekretuan nga Ushtruesja e Detyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës në fillim të vitit 2021.
- Gjithashtu, KGjK avancoi nëntë (9) gjyqtarë duke i plotësuar pozitat vakante në Gjykatën Supreme, në atë të Apelit, përfshirë pozitat e lira në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës së Apelit dhe të Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
- Po ashtu, KGjK emëroi kryetarët e Gjykatës Themelore në Pejë dhe Gjykatës Themelore në Gjakovë si dhe gjyqtarin mbikëqyrës të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, dega Leposaviq.
- U përfundua vlerësimi i performancës së njëqind e njëzet e gjashtë (126) gjyqtarëve të cilët kishin aplikuar për ngritje në detyrë, apo ishin kandidatë për emërim të përhershëm.
- Në pajtim me Ligjin për Procedurë Disiplinore, duke zbatuar mekanizmat e kontrollit të sjelljes etike dhe disiplinës së gjyqtarëve shqyrtoi njëqind e tridhjetë e pesë (135) ankesa ndaj gjyqtarëve. Prej tyre, njëzet (20) kërkesa për fillimin e hetimeve u pranuan në Këshill. Prej tyre, Autoritetet Kompetentë i hodhën njëqind e njëzet e gjashtë (126) ankesa si të pabazuara. Prej njëqind e njëzet e gjashtë (126) ankesave, katër (4) prej tyre ishin të vitit 2019, ndërsa njëqind

e njëzet e dy (122) të vitit 2020. Prej ankesave të dorëzuara në vitin 2020 në Këshill u dorëzuan njëzet (20) kërkesa për iniciimin e procedurës hetimore dhe themelimin e paneleve hetimore. Dy prej tyre u pushuan për shkak të vdekjes së subjektit të procedurës, përderisa hetimet vazhduan në tetëmbëdhjetë (18) rastet e mbetura. Prej tyre trembëdhjetë (13) procedura hetimore u përfunduan, dhe pesë (5) procedura hetimore ishin në proces e sipër në fund të vitit.

Si rezultat i procedurave hetimore, gjatë vitit 2020, Këshilli pezulloi një (1) gjyqtarë nga detyra për shkak të akuzës se ka kryer vepër penale. Dhe shqiptoi dy (2) vërejtje jo publike me shkrim, dhe një (1) vërejtje publike me shkrim. Këshilli, gjithashtu shqiptoi dënime me zvogëlim të pagës për një periudhe të caktuar për tre (3) gjyqtarë.

- Gjithashtu, gjatë vitit 2020 u shënuar progres i rëndësishëm në përmirësimin dhe ngritjen e transparencës së punës së gjyqësorit. Me ndihmën e programit të USAID u ristrukturua faqja e internetit. Është me rëndësi të ceket se gjykatat publikuan më tepër se 35,000 aktgjykime duke e përmirësuar qasjen e qytetarëve në punën e gjykatave. Këshilli, lansoi aplikacione të ndryshme për të përmirësuar qasjen në drejtësi përfshirë, mundësinë për vlerësimin e shërbimeve të gjykatës, kalkulimin e taksave gjyqësore dhe mundësinë për kalkulimin e sanksioneve penale. Aplikacione këto të mbështetura nga USAID dhe Ambasada Amerikane në Prishtinë.

Këshilli, lansoi pasqyrën e performancës përmes së cilës qytetarët mund të mësojnë më tepër lidhur me performancën e gjyqësorit, përfshirë performancën individuale të gjyqtarëve.

- Dhe në fund, gjatë vitit 2020 me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe pa pajtimin e Këshillit, buxheti i gjyqësorit pësoi shkurtime të rëndësishme, shkurtime të cilat afektuan mundësitë e këshillit për të i realizuar të gjitha aktivitetet. Kërkesa buxhetore e Këshillit e dorëzuar Kuvendit të Kosovës për vitin 2020, ishte në vlerë të 29,821,540€. Pas rishikimit të tij nga Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës, buxheti i aprovuar për KGJK ishte më i ulët për 1,446,089€, duke arritur shumën prej 28,275,451€.

Me vendimet e mëvonshmet të Qeverisë së datës 25 nëntor, 2020 dhe 21 dhjetor 2020, buxheti i gjyqësorit u shkurtua më tej edhe për 379,589.19€. Duke e ulur vlerën e përgjithshme të buxhetit në 27,995,861.81€.

Struktura e Përgjithshme e Raportit

Në pjesën hyrëse, raporti përbëhet nga pjesë të standardizuara të realizimit të punëve gjatë vitit 2020, në këtë hyrje janë paraqitur vizioni, misioni, struktura, kompetencat dhe baza ligjore e funksionimit të Këshillit, kurse në pjesën e dytë, aktivitetet e Këshillit, si: takimet, avancimi i gjyqtarëve, aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit, hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore rregulloret, udhëzimet administrative dhe vendimet, gjithashtu edhe komisionet e Këshillit dhe komisionet ad hoc.

Raporti mbulon edhe aktivitetet e Gjykatave dhe Sekretariatit në kuadër të menaxhimit të burimeve njerëzore, buxhetit dhe financave, performancës dhe statistikës, logjistikës, auditimit të brendshëm, teknologjisë informative, prokurimit, evidencës penale etj. Kujdes i veçantë i është kushtuar të arriturave të Këshillit si dhe përmbushjes së obligimeve të dala nga raportet vlerësuese të vendit dhe atyre ndërkombëtare ku edhe e kemi pasqyruar në këtë raport. Në vijimësi të Raportit prezantohet edhe puna e Panelit për Lirim me Kusht, Njësisë së Inspektimit Gjyqësor dhe Vlerësimit dhe Verifikimit të Gjyqësor.

Raporti përmban edhe të dhëna me rëndësi për buxhetin e sistemit gjyqësor me fokus në kategoritë e pagave dhe mëditjeve, mallrave dhe shërbimeve, shpenzimeve komunale si dhe investimeve kapitales. Me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe transparencës, KGjK ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me institucione dhe organizata joqeveritare si bashkëpunim ndërinstitutional të cilat i kemi bërë publike. Ndërsa, në fund janë paraqitur sfidat kryesore me të cilat është ballafaquar Këshilli Gjyqësor i Kosovës, gjatë vitit 2020.

2.0 INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR KËSHILLIN

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe të Ligjit për Gjykatat, u vunë themelet e një strukture të re organizative të gjyqësorit, si dhe u vendosën premiset mbi të cilat ndërtohet një gjyqësor i pavarur i cili administrohet nga vetë profesionistët e gjyqësorit.

Çështjet e emërimit dhe riemërimit të gjyqtarëve, vlerësimi i performancës së tyre, trajnimet gjyqësore, avancimi në detyrë, etika profesionale, disiplinimi, administrimi gjyqësor dhe menaxhimi, buxheti i gjyqësorit, bien nën kompetencën e Këshillit dhe janë kritere bazë që garantojnë pavarësinë e gjyqësorit. Përmes këtyre instrumenteve kushtetuese dhe ligjore, pozita e gjyqësorit është fuqizuar, është vënë në vendin e merituar, në të njëjtin nivel me dy pushtetet tjera.

2.1 Vizioni

Vizioni i Këshillit është një sistem gjyqësor kosovar që është i pavarur, i qasshëm për të gjithë, i drejtë dhe efikas në punën e tij, që jep llogari në punën e vet, që është funksional dhe që u përmbahet standardeve më të larta të ndershmërisë, integritetit, kompetencës, profesionalizmit dhe transparencës.

2.2 Misioni

Misioni i Këshillit është të krijohet dhe të ruhet një sistem gjyqësor kosovar i pavarur, që iu ofron shërbime gjyqësore të paanshme të gjithëve dhe që është funksional në të gjitha aspektet organizative dhe operative.

2.3 Roli dhe kompetencat e Këshillit

Kompetencat e KGjK-së janë të përcaktuara në Kushtetutë dhe në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në bazë të të cilave KGjK ka rol fundamental në sigurimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së sistemit gjyqësor. KGjK është themeluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si organ qeverisës i gjyqësorit. Këshilli është plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij. KGjK është përgjegjës për rekrutimin e gjyqtarëve dhe propozimin për emërimin e tyre, inspektimin gjyqësor, menaxhimin e administratës gjyqësore dhe buxhetit si dhe përcaktimin e rregullave për funksionimin e duhur të gjykatave. Gjithashtu, Këshilli është përgjegjës për transferimin dhe për procedurën disiplinore kundër gjyqtarëve.

2.4 Përbërja e Këshillit

KGjK në përbërjen e tij parashihet të ketë trembëdhjetë (13) anëtarë: gjashtë (6) anëtarë zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa shtatë (7) anëtarë zgjedhën drejtpërdrejt nga gjyqësori. Mandati i anëtarëve të Këshillit është pesë (5) vjeçar. Këshilli në fillim të vitit 2020 kishte nëntë (9) anëtarë. Në muajin shkurt, Këshilli zgjodhi dy (2) anëtarë të ri nga gjyqësori, Qerim Ademaj – gjyqtar nga Gjykata e Apelit dhe Avni Mehmeti - nga Gj.Th. e Mitrovicës. Ndërsa, në të njëjtin muaj mandati i përfundoj gjyqtarit Gjimshit Galushi, ndërsa në muajin gusht të vitit 2020, gjyqtares Makifete Saliuka. Gjatë vitit 2020, Kuvendi i Republikës së Kosovës zgjodhi dy anëtarë të ri të Këshillit, nga tre (3) sa ishte duhur t'i zgjidhte. Anëtarët e zgjedhur janë gjyqtari Driton Muharremi nga Gjykata e Apelit dhe Vilard Bytyqi. Në fund të vitit 2020 Këshilli përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë.

Në përbërje gjyqësori ka siguruar që anëtarët e zgjedhur nga gjyqësori të jenë në pajtim me parimet e barazisë gjinore. Nga shtatë (7) anëtarët e zgjedhur nga gjyqësori, gjithsej tre (3) janë të gjinisë femërore dhe katër (4) të gjinisë mashkullore. Për më tepër në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës katër (4) nga anëtarët e Këshillit i përkasin pakicave kombëtare. Nga katër (4) pozitat e parapara për minoritete vetëm një është e hapur.

3.0 AKTIVITETET E KËSHILLIT

Këshilli Gjyqësor i Kosovës gjatë vitit 2020, ka mbajtur njëzet e dy (22) takime, përfshirë këtu takimet e jashtëzakonshme dhe takimet e mbajtura përmes platformave elektronike (zoom). Gjatë kësaj periudhe raportuese, Këshilli ka nxjerrë gjithsejtë dyqind e nëntëdhjetë e nëntë (299) vendime.

KGJK, gjatë vitit 2020, ka punuar dukshëm në plotësimin e pozitave të hapura për gjyqtarë, përfshirë gjyqtarë të ri në Gjykatat Themelore si dhe duke i plotësuar pozitat e hapura në Gjykatën e Apelit dhe atë të Supremes. Këshilli kujdes të veçantë gjatë procesit të rekrutimit i ka kushtuar plotësimin të pozitave në Departamentet Specialë të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe asaj të Apelit. Gjatë vitit ka avancuar nëntë (9) gjyqtarë, prej tyre dy (2) gjyqtar në Gjykatën Supreme, shtatë (7) gjyqtar në shkallën e dytë, përkatësisht tre (3) gjyqtar në Gjykatën e Apelit, tre (3) në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës së Apelit dhe një (1) në Gjykatën e Apelit - Divizioni në Mitrovicë. KGJK ka përzgjedhur dhe caktuar gjashtë (6) gjyqtarë në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë. KGJK, gjithashtu përfundoi procesin e rekrutimit të njëzet e shtatë (27) gjyqtarëve dhe i dorëzoi tek Presidenti i Republikës së Kosovës për dekretim.

Po ashtu, KGJK ka emëruar kryetarët e Gjykatës Themelore në Pejë dhe Gjykatës Themelore në Gjakovë si dhe gjyqtarin mbikëqyrës të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, dega Leposaviq. Gjatë kësaj periudhe, janë riemëruar me mandat të përhershëm pesëdhjetë e dy (52) gjyqtarë në gjykatat themelore. Po ashtu, KGJK ka organizuar zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Këshillit nga radhët e gjyqësorit.

Këshilli ka hartuar dhe miratuar Planin Strategjik tri (3) vjeçar, 2020-2022 duke i përcaktuar prioritetet e gjyqësorit për tri (3) vitet e ardhshme. Strategjia është fokusuar në pesë (5) shtyllat kryesore:

1. Besimi dhe besueshmëria e publikut;
2. Administrimi efektiv dhe efikas i drejtësisë;
3. Profesionalizimi dhe kompetenca;
4. Transparenca dhe llogaridhënia;
5. Qasja në drejtësi.

Për të gjitha shtyllat, Këshilli ka përcaktuar një numër të qëllimeve të cilat do të arrihen brenda kësaj periudhe. Vlen të theksohet se në këtë Strategji janë fuzionuar rekomandimet e Rishikimit Funkcional të Sistemit të Drejtësisë për të harmonizuar punën.

Përveç kësaj, Këshilli ka miratuar planin e punës për vitin 2020. Ky plan i punës është hartuar në pajtim me objektivat strategjike të mishëruara në Strategjinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitet 2020-2022. Prandaj, edhe ky plan përfshin të gjitha shtyllat kryesore sikur se Strategjia, duke i specifikuar veprimet e planifikuara, kohën për kryerjen e këtyre veprimeve, stafin, apo zyrat përgjegjëse.

3.1 Komisionet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Duke u bazuar në nenin 16 të ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshilli ka themeluar këto Komisione të Përhershme:

- Komisionin për Çështje Normative;
- Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel;
- Komisionin për Administrimin e Gjykatave;
- Komisionin për Vlerësimin e Përformances Gjyqësore;

- Komisionin për Trajnime.

Më qëllim të zbatimit të rregulloreve të brendshme, KGJK ka themeluar edhe:

- Komisionin për Emërimin e Gjyqtarëve;
- Komisionin për Kompensimin e Personave të Dënuar, ose të Arrestuar pa arsye.

Komisionet e KGJK-së janë themeluar për të mbështetur atë në ushtrimin e mandatit të tij. Secili Komision ka se paku tre (3) anëtarë, të cilët KGJK i zgjedh me mandat dy (2) vjeçar.

3.1.1 Komisioni për Çështje Normative

Komisioni për Çështje Normative, gjatë kësaj periudhe ka mbajtur nëntë (9) takime të rregullta me partnerët vendor dhe ndërkombëtar, për të hartuar aktet nën ligjore të cilat kanë për qëllim harmonizimin e legjislacionit rregullativ të Këshillit me Ligjin për KGJK dhe Ligjin për Gjykata. Më tej, aktivitetet e këtij Komisioni u përqendruan në përmirësimin dhe avancimin e strukturës së Këshillit si dhe Sekretariatit të KGJK-se.

Takimet e mbajtura pas shfaqjes së Pandemisë COVID-19, janë zhvilluar komfor vendimeve, udhëzimeve dhe instruksioneve të Institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e pandemisë, e rrjedhimisht vendimeve të nxjerra nga KGJK-ja gjatë kësaj periudhe, si dhe Planit për Menaxhimin e Krizave të miratuar nga Këshilli lidhur me këtë çështje. Gjatë këtyre takimeve, fillimisht është trajtuar Plani Vjetor i Punës se këtij Komisioni, për vitin 2020, i cili është miratuar nga KGJK dhe janë miratuar tri (3) Rregullore dhe një (1) Plotësim Ndryshim Rregullore.

Komisioni për Çështje Normative për vitin 2020, ka shqyrtuar dhe ka rekomanduar në Këshill katër (4) rregullore të cilat janë miratuar dhe janë si në vijim:

- Rregullore Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës;
- Rregullore Nr.03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Rregullore Nr. 04/2020 për Autoritetin, Organizimin dhe Funkcionimin e Njesisë së Inspektimit Gjyqësor;
- Rregullore (Nr.01/2020) për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores (Nr.09/2016) për Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës.

3.1.2 Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel

Komisioni gjatë vitit 2020, ka shqyrtuar dhe rekomanduar për aprovim në Këshill buxhetin e gjyqësorit për vitin 2021.

3.1.3 Komisioni për Administrimin e Gjykatave

Komisioni për Administrimin e Gjykatave është Komision i përhershëm i Këshillit, i cili përgatitë dhe rekomandon politika për administrimin e gjykatave. Gjatë vitit 2020, ka mbajtur tetë (8) takime pune dhe ka trajtuar me profesionalizëm dhe përkushtim nevojën e unifikimit të praktikës së administratës në të gjitha gjykatat e Kosovës. Në kuadër të kompetencave të veta, ka nxjerrë dhe i ka rekomanduar Këshillit Gjyqësor të Kosovës për miratim:

- Memorandum shpjegues për evitimin e shtyrjes së seancave në gjykatat themelore, përfshirë masat që duhet të ndërmerren për të i evituar ato në të ardhmen;
- Memorandum shpjegues për caktimin e ekspertëve të gjeodezisë nga gjykatat themelore;

- Memorandum shpjegues, për miratimin e listës së kandidatëve për krijimin e komisioneve për vlerësimin dhe testimin e kandidatëve për interpret dhe përkthyes gjyqësorë për çift gjuhësh: a) Shqip-Serbisht dhe anasjelltas si dhe b) Serbisht-Anglisht dhe anasjelltas;
- Memorandum shpjegues për miratimin e Planit të Punës së Njësisë së Inspektimit Gjyqësor për vitin 2021.

Komisioni për Administrimin e Gjykatave në vazhden e punëve të tij ka shqyrtuar dhe i rekomanduar Këshillit për miratim draft aktet si në vijim:

- Draft - Rregullore për Organizimin edhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave;
- Draft - Plani i Veprimit për Menaxhimin e Krizës Emergjente.

Në vijim të veprimtarisë së vet, Komisioni ka shqyrtuar dhe ka miratuar Koncept dokumentet e hartuara nga Programi USAID-it për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë në (JSSP), si :

- Koncept - Dokument për Bashkëpunëtorë Profesional;
- Forma dhe Përmbajtja e Planit të Punës së Gjykatës Themelore;
- Procedura Standarde e Veprimit për Praktikantët Gjyqësorë.

Të njëjtat ia ka paraqitur Komisionit për Çështje e Normative, për procedim të mëtejme. Gjithashtu, Komisioni ka shqyrtuar Udhëzuesin për Praktikantët më të mira, të hartuar nga JSSP dhe ka nxjerr:

- Memorandum shpjegues mbi nxjerrjen e përfundimit mbi aprovimin e Udhëzuesit për praktikantët më të mira/Përmirësimi i menaxhimit të ngarkesës me lëndë në Gjykatat e Kosovës, i hartuar nga Programi i USAD-it për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë

(JSSP), adresuar kryetarëve të gjykatave me sugjerimin, që ta zbatojnë të njëjtin me qëllim të rritjes së efikasitetit në punën e tyre;

- Komisioni për Administrimin e Gjykatave ka hartuar dhe miratuar Draft-Udhëzim Administrativ për Zbatimin të Orarit të Ruajtjes dhe Asgjësimit të të Dhënave Gjyqësore si dhe Planin e Punës së KAGj për vitin 2021.

3.1.4 Komisioni për vlerësimin e Performancës së gjyqtarëve

Komisioni për vlerësimin e Performancës së gjyqtarëve është Komision i përhershëm i KGjK-së, i cili ka kompetencë vlerësimin e performancës së gjyqtarëve për periudha të caktuara kohore. Baza juridike për vlerësimin e gjyqtarëve është e përcaktuar në nenin 27, të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Qëllimi i vlerësimit të performancës së gjyqtarëve është matja e sasisë dhe cilësisë së punës së gjyqtarëve. Këto vlerësime paraqesin bazë për ngritje, apo për ulje në detyrë si edhe për propozimin e shkarkimit nga detyra. Vlerësimit të performancës i nënshtrohen të gjithë gjyqtarët e gjykatave të Kosovës.

Ky komision, përfaqëson tri nivelet e shkallëshmërisë së sistemit gjyqësor të Kosovës dhe përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë të cilët zgjedhën nga ana e KGjK-së, duke u përzgjedhur:

- Pesë (5) anëtarë, nga Gjykata Supreme;
- Katër (4) anëtarë, nga Gjykata e Apelit;
- Tre (3) anëtarë, nga Gjykatat Themelore dhe
- Një (1) kryetar, nga anëtarët e KGjK-së, i cili udhëheqë punët e komisionit, por nuk është anëtar vlerësues.

Po ashtu, Komisioni ka kryer edhe këto punë:

- Janë mbajtur shtatë (7) seanca plenare;
- Janë përfunduar njëqind e njëzet e gjashtë (126) vlerësime të gjyqtarëve sipas kategorive vlerësuese:
 - Tridhjetë e nëntë (39) vlerësime të gjyqtarëve fillestarë, pas trajnimit nga Akademia e Drejtësisë;
 - Pesëdhjetë e dy (52) vlerësime për gjyqtarët të cilët kishin përfunduar mandatin fillestar (ri emërim);
 - Tridhjetë e pesë (35) vlerësime të gjyqtarëve për ngritje në detyrë;
- Është përgatitur Plani e Punës së Komisionit për vitin 2021.

3.1.5 Komisioni për trajnime

Komisioni për Trajnime ushtron detyra dhe përgjegjësi bazuar në Ligjin e KGjK-së, Nr.06/L-055 dhe në Rregulloren për Trajnimin e Gjyqtarëve të miratuar nga Këshilli. Gjatë vitit 2020, Komisioni ka mbajtur takime dhe takime koordinuese me Akademinë e Drejtësisë. Gjatë kësaj periudhe, Komisioni ka pasur mbështetje nga Projekti i USAID për Fuqizimin e Sektorit të Drejtësisë - JSSP, i cili ka bërë monitorimin e zbatimit të trajnimit të vazhdueshëm dhe të trajnimit fillestar, si dhe i ka rekomanduar Akademisë mbajtjen e trajnimeve për fusha të ndryshme.

3.1.6 Komisioni për Kompensimin e Dëmit për personat e dënuar, ose arrestuar pa arsye

Komisioni për Kompensimin e Demit për personat e dënuar, ose arrestuar pa arsye përbëhet prej tre (3) anëtarësh dhe dy (2) anëtar rezervë, njeri kryetar dhe dy (2) anëtar të rregullt si dhe dy (2) anëtarë rezerve. Komisioni për kompensimin e demit për personat e dënuar, ose arrestuar pa arsye, gjatë vitit 2020, ka shqyrtuar dhe kompensuar gjithsej, njëqind e pesë (105) raste në shumën prej, 244,800.00€, për shkak të privimit të tyre pa bazë ligjore dhe pa arsye.

3.1.7 Procedura disiplinore e gjyqtarëve

Këshilli Gjyqësor i Kosovës nga fillimi i janarit të vitit 2020, ka pranuar njëqind e tridhjetë e pesë (135) ankesa disiplinore të ushtruara nga personat fizik dhe juridik ndaj gjyqtarëve, ankesa këto të trajtuara nga autoritetet kompetente dhe Këshilli. Nga këto njëqind e tredhjet e pesë (135) ankesa, Këshilli ka pranuar njëqind e njëzet e gjashtë (126) vendime nga Autoritetet Kompetente me të cilat ankesat janë refuzuar si të pa bazuara, prej tyre katër (4) vendime për refuzim kanë qenë në lidhje me ankesat e pranuar në fund të vitit 2019, si dhe njëqind e njëzet e dy (122) vendime për refuzimin e ankesave të vitit 2020.

Nga numri total i ankesave të theksuara më lartë për vitin 2020, KGjK ka pranuar nga Autoritete Kompetente, njëzet (20) kërkesa për inicim të hetimit disiplinor, prej të gjitha këtyre kërkesave dy (2) ankesa të cilat kanë rezultuar në kërkesa për inicim të procedurës janë pranuar në fund të viti 2019, ndërsa tetëmbëdhjetë (18) kërkesa janë pranuar gjatë vitit 2020.

Pas shqyrtimit të këtyre kërkesave për inicim të hetimeve disiplinore, KGjK ka themeluar tetëmbëdhjetë (18) Panele Hetimore, ndërsa për dy (2) kërkesa KGjK ka pushuar hetimin disiplinor për shkak të vdekjes së subjektit hetimor, i cili ka qenë i njëjti në të dy rastet.

Këshilli në përputhje me nenin 12, paragrafi 9, të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, e ka pezulluar me vendim, një (1) gjyqtarë nga detyra për shkak të dyshimit për kryerje të veprës penale. Në këtë drejtim, nga tetëmbëdhjetë (18) panele hetimore të themeluara, KGjK ka pranuar trembëdhjetë (13) raporte mbi faktet dhe provat e mbledhura, ndërsa pesë (5) panele tjera janë në fazën e hetimeve, ashtu siç parashihet me Ligj. KGjK, ka mbajtur njëzet (20) seanca dëgjimore dhe nga trembëdhjetë (13) raporte të cekura më lartë ka shqyrtuar gjithsej, njëmbëdhjetë (11) raporte mbi faktet dhe provat e mbledhura, si dhe nëntë (9) raporte të pranuar në vitin 2020, nga panelet hetimore të themeluara në fund të vitit 2019.

Në seancat e cekura më lartë pas shqyrtimit të raporteve, janë marrë gjithsej, nëntëmbëdhjetë (19) vendime dhe janë shqiptuar këto masa:

- Vërejtje jo publike me shkrim, dy (2) vendime;
- Vërejtje publike me shkrim, një (1) vendim;
- Nuk është përgjegjës, trembëdhjetë (13) vendime;
- Zvogëlim i përkohshëm i pagës prej 10% për periudhën kohore prej katër (4) muaj, një (1) vendim; Zvogëlim i përkohshëm i pagës prej 30%, për periudhën kohore prej katër (4) muajve, një (1) vendim; Zvogëlim i përkohshëm i pagës prej 30% për periudhën kohore prej gjashtë (6) muaj, një (1) vendim.

3.2 Aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK), gjatë vitit 2020, në bazë të kompetencave ligjore për përfaqësimin e Këshillit para publikut, institucioneve vendore dhe ndërkombëtare ka zhvilluar vizita dhe ka marr pjesë në konferenca, forume dhe tryeza të ndryshme.

3.2.1 Takimet me partnerë ndërkombëtar

Kryesuesi ka zhvilluar takime me Ambasadën Amerikane në Kosovës, Ambasadën e Britanisë së Madhe në Kosovës të cila janë zhvilluar në suaza të bashkëpunimit dhe mbështetjes që këto shtete japin për sistemin gjyqësor në Kosovë. Në kuadër të takimeve me partnerë ndërkombëtar ka zhvilluar takime tjera, si: EULEX-in, Komisionin e Venecias, Zyrën e BE-së në Prishtinë, Këshillin e Evropës, USAID, OSBE, UNDP, GIZ, si dhe përfaqësues të projekteve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

3.2.2 Pjesëmarrja e Kryesuesit në konferenca, forume dhe tryeza

Gjatë vitit 2020, Kryesuesi i KGjK, në përmbushje të mandatit për përfaqësim të Këshillit, ka marr pjesë në konferenca, forume dhe tryeza pune, disa prej të cilave po i paraqesim si në vijim:

- Konferenca Vjetore e Prokurorëve;
- Përmbyllja e projektit për mbështetje në Luftën kundër Krimin të Organizuar, Korrupsionit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm;
- Punëtori për hartimin e trajnimit fillestar për gjeneratën e tretë organizuar nga Akademia e Drejtësisë;

- Konferenca “Shpalosja e rezultateve të Anketës me përdoruesit e shërbimeve të gjykatave”, organizuar nga Demokracia Plus dhe Qendra për Avokim dhe Kulturë Demokratike (ACDC);
- Lansimi ceremonial i aktiviteteve të Institutit për Hulumtime dhe Studime Juridike, në Gjykatoren e Fakultetit Juridik - UP;
- Ndarja e çmimit ‘Gjykata më transparente’, organizuar nga BIRN dhe FOL;
- Konferenca online lidhur me 70 vjetorin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- ‘Dita ndërkombëtare e demokracisë’, organizuar nga UNDP;
- Forcimi i Institucioneve të Kosovës në Luftën kundër Torturës, Keqtrajtimit dhe Trajtimit të Tjerë Degradues përmes platformave online, organizuar nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë;
- Takim me përfaqësues të shoqërisë civile;
- Takime me anëtarë dhe përfaqësues të KPK-së;
- Takime me grupin punues për Rishikim FunkSIONAL të Sektorit për Sundimin e Ligjit.

3.3 Menaxhimi i aktiviteteve në Këshill dhe Gjykata gjatë Pandemisë COVID-19

Pas paraqitjes së pandemisë, KGJK veprroi me urgjencë duke hartuar dhe miratuar Planin Emergjent për Menaxhimin e Krizave, në bazë të së cilit është përcaktuar mënyra e punës në gjykata gjatë kohës së pandemisë dhe mënyra e menaxhimit të gjykatave, caktimi i punonjësve kujdestar dhe trajtimi i rasteve emergjente.

Në muajin mars 2020, pas marrjes së vendimit nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, edhe Këshilli veprroi njëjtë duke kufizuar përkohësisht aktivitetet gjyqësore.

Në përputhje me këtë, Këshilli mori vendim për reduktimin e stafit në gjykata dhe në të njëjtën kohë, kërkoi nga kryetarët e gjykatave që të caktojnë gjyqtarët dhe stafin administrativ, vetëm për rastet e natyrës urgjente. Pas kësaj, Këshilli në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar, miratoi Planin për Menaxhimin e Krizës. Pas miratimit, Këshilli dërgoi këtë plan tek kryetarët e gjykatave me qëllim që të implementohet në çdo gjykatë në përshtatshmëri me gjendjen aktuale të secilës Gjykatë.

Qëllimi i këtij Plani është që të sigurohet mbarëvajtja e punës në sistemin gjyqësor për një periudhë më të gjatë kohore, duke ju përshtatur rrethanave emergjente dhe në përputhshmëri me vendimet e institucioneve relevante. Përmes këtij plani, Këshilli ka arritur që të siguroj vazhdimin e funksionimit të institucioneve gjyqësore në rrethanat e situatave emergjente, duke përfshirë masat e rrepta të emergjencës shëndetësore dhe relaksimin e masave.

Gjatë kësaj kohe, Këshilli vazhdimisht ka kërkuar nga gjykatat që të kenë fokus lëndët të cilat kanë qenë në përfundim, lëndët të cilat kanë rrezik të parashkrimit, lëndët e shënjestruara, lëndët me paraburgim, dhunë në familje, etj., duke organizuar punën në përputhje me Planin Emergjent për Menaxhimin e Krizës, të aprovuar nga KGjK. Bazuar në gjendjen emergjente të shpallur për shëndetin publik si rezultat i pandemisë globale, KGjK në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë, ka obliguar gjyqtarët të cilët kanë qenë pjesë e programit të trajnimit fillestar për arsimim të vazhdueshëm pranë Akademisë së Drejtësisë, të vazhdojnë vijimin e ligjëratave përmes sistemit të mësimin në distancë/përmes platformave online.

4.0 AKTIVITETET E SEKRETARIATIT TË KËSHILLIT

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është organ administrativ profesional i themeluar me Ligj për Këshillin Gjyqësor të Kosovës i cili në kuadër të tij ka strukturën e vet organizative me të cilën ofron mbështetje profesionale dhe administrative Këshillit dhe gjykatave. Ky organ, përbëhet nga nëpunësit civil dhe zyrtarët e angazhuar në bazë të marrëveshjeve të veçanta të cilët përbëjnë administratën qendrore të sistemit gjyqësor të Kosovës.

Brenda strukturës së tij, Sekretariati ka këtë rregullim organizativ:

- Departamenti i Administratës së Përgjithshme;
- Departamenti Ligjor;
- Departamenti për Buxhet e Financa;
- Departamenti për Teknologji Informative dhe Komunikim;
- Departamenti i Auditimit të Brendshëm;
- Departamenti Logjistikës;
- Departamenti i Statistikës;
- Zyra e Prokurimit;
- Zyra për Përkthim dhe Mbështetje;
- Zyra për Evidencë Penale;
- Integrimi evropian;
- Komunikimi me publikun;
- Certifikuesi.

4.1 Zyra e Drejtorit

Bazuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit është Zyrtari Kryesor Administrativ. Sekretariati administron buxhetin e miratuar të gjyqësorit, menaxhon me personelin administrativ dhe mbështetës të gjyqësorit, bazuar në ngarkesën me punë, mirëmbajtjen e regjistrave të personelit, themelimin e sistemit të vlerësimit të performancës, sigurimin e disiplinimit të duhur të punonjësve të gjykatës si dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre të punësimit; siguron që gjykatat të kenë furnizim të duhur dhe me kohë me materialet e nevojshme për funksionimin efikas dhe efektiv të gjykatave; ofron mbështetje administrative dhe profesionale për Këshillin dhe Komisionet e Këshillit dhe ndërmerr detyra dhe autorizime të tjera sipas Udhëzimeve të Këshillit. Drejtori i raporton Këshillit dhe Kryesuesit të Këshillit.

Ndër të tjera, në kuadër të përgjegjësive të tij, gjatë periudhës raportuese Drejtori i Përgjithshëm:

- Ka nxjerr katërqind e pesëdhjetë e gjashtë (456) vendime të ndryshme;
- Ka mbajtur njëqind e njëzet e shtatë (127) takime zyrtare;
- Ka nënshkruar shtatëdhjetë e nëntë (79) akt emërimi, dhe pesëmbëdhjetë (15) marrëveshje për shërbime të veçanta.

4.1.1 Departamenti i Administratës së përgjithshme

Ky Departament është nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Përgjithshmen të Sekretariatit, në të cilin aktualisht punojnë dy (2) punëtorë staf administrativ. Gjatë vitit 2020, janë realizuar aktivitetet si në vijim:

Pozitat e aprovuara

Me Ligjin mbi Buxhetin e vitit 2020, për vijën buxhetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë lejuar gjithsej: dymijë e njëqind e trembëdhjetë (2113) pozita. Vlen të theksohet se Buxheti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës është shkurtuar për njëqind e gjashtëdhjetë e tetë (168) pozita në vitin 2020.

Shpërndarja e pozitave

- Për gjyqtarë janë lejuar katërqind e pesëdhjetë e dy (452) pozita (nga këto pozita, dyzetë tetë (48) për implementimin e Marrëveshjes së Brukselit për Divizionin e Apelit në Mitrovicë dhe gjykatat themelore);
- Për staf administrativ në gjykata, Sekretariat dhe njësitë e Këshillit janë lejuar njëmijë e gjashtë qind e gjashtëdhjetë e një (1661) pozita (nga këto, njëqind e pesëmbëdhjetë (115) pozita janë për implementimin e Marrëveshjes së Brukselit për Divizionin e Apelit në Mitrovicë dhe gjykatat themelore).

Në kuadër të Këshillit, kemi këto programe buxhetore:

- Programi buxhetor i Sekretariatit të Këshillit, tetëdhjetë e dy (82) pozita, prej tyre dy (2) pozita janë të rezervuara për Kryesues dhe Zëvendës kryesues, dhe dy (2) pozita ish zyrtarëve të lartë (ish kryetarët e Gjykatës Supreme) nga radhët e pozitave të gjyqtarëve;
- Programi buxhetor i Gjykatës Supreme me Dhomën e Posaçme – Nëntë dhjetë e pesë (95) pozita (prej tyre tridhjetë e nëntë (39) pozita për gjyqtarë);
- Programi buxhetor i Gjykatës së Apelit – Njëqind e dyzet e katër (144) pozita (prej tyre pesëdhjetë e dy (52) pozita për gjyqtarë);

- Programi buxhetor i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Katërqind e nëntëdhjetë e pesë (495) pozita (prej tyre njëqind e shtatë (107) pozita për gjyqtarë);
- Programi buxhetor i Gjykatës Themelore në Prizren – Dyqind e tetëmbëdhjetë (218) pozita (prej tyre dyzet e gjashtë (46) pozita për gjyqtarë);
- Programi buxhetor i Gjykatës Themelore në Pejë – Dyqind e njëzet e dy (222) pozita (prej tyre dyzet e një (41) pozita për gjyqtarë);
- Programi buxhetor i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Treqind e njëzet e nëntë (329) pozita (prej tyre gjashtëdhjetë e katër (64) pozita për gjyqtarë);
- Programi buxhetor i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dyqind e tetë (208) pozita (prej tyre tridhjetë e nëntë (39) pozita për gjyqtarë);
- Programi buxhetor i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Njëqind e gjashtëdhjetë e pesë (165) pozita (prej tyre tridhjetë e dy (32) pozita për gjyqtarë);
- Programi buxhetor i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Njëqind e dyzet e tetë (148) pozita (prej tyre njëzet e tetë (28) pozita për gjyqtarë);
- Programi buxhetor i Njësisë për Inspektim Gjyqësor - Shtatë (7) pozita.

Komfor ndryshimeve ligjore është nxjerrë Udhëzimi Administrativ (Nr. 01/2019), Për ndarjen e përgjegjësive të SKGjK-së dhe të gjykatave në Çështjet e Personelit, Buxhetit dhe Financave, Logjistikës dhe Prokurimit, dhe tani të gjitha çështjet që kanë të bëjnë lidhur me personelin, janë nën menaxhimin e Departamentit të Administratës së Përgjithshme.

Procedura të rekrutimit/ Punësime të reja

Në gjyqësorin e Kosovës (SKGJK dhe gjykata) kanë qenë të publikuara gjithsej: nëntëdhjetë e një (91) pozita për shërbyes civil.

Avancime: njëzet e gjashtë (26) pozita janë publikuar përmes konkursit të brendshëm (avancim):

- Njëzet e katër (24) të realizuara;
- Dy (2) të anuluar si procedura.

Konkurs publik i jashtëm: gjashtë dhjetë e dy (62) pozita janë publikuar përmes konkursit të jashtëm:

- Pesëdhjetë e dy (52) të realizuara;
- Dhjetë (10) të anuluar si rezultat i shkurtimeve buxhetore.

Mënyrë tjetër: tri (3) pozita të realizuara:

- Dy (2) të realizuara përmes transferimit nga Institucioni në Institucion;
- Një (1) e realizuar përmes Young Cell Scheme –YCS

Përfundim i marrëdhënies së punës

Në gjyqësorin e Kosovës (SKGjK dhe gjykata) kemi pasur gjithsej: shtatëdhjetë e pesë (75) përfundime të marrëdhënies së punës:

- Pesëdhjetë e shtatë (57) me pensionim;
- Nëntë (9) me vdekje;
- Katër (4) me dorëheqje;
- Pesë (5) me procedurë disiplinore.

4.1.2 Departamenti Ligjor

Departamenti Ligjor, gjatë vitit 2020 ka realizuar aktivitete të shumta ku në kuadër të kompetencave dhe detyrave të punës, ka hartuar akte nënligjore si:

- Ofrimi i udhëzimeve dhe monitorimin e shërbimeve në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore për Këshillin dhe Komisionet e Këshillit;
- Hartimi i raporteve, opinioneve ligjore, vendimeve;
- Kontrolli i pajtueshmërisë së akteve nënligjore të Këshillit me Kushtetutën e Kosovës dhe legjislacionet në fuqi në Kosovë;
- Ofrimi i këshillave dhe analizave ligjore për veprimtarinë e Këshillit dhe dokumenteve tjera sipas kërkesës së Këshillit, gjykatave dhe nevojave të Sekretariatit;
- Hartimi i shkresave dhe akteve të ndryshme për nevojat e Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Njësive të Sekretariatit, përfshirë kontrollin ligjor të tyre;
- Angazhimi dhe ndihma profesionale dhe administrative rreth çështje organizative të takimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të KGjK-së dhe Komisioneve të tij.

Departamenti ka përfaqësuar KGjK-në në konteste të ndryshme gjyqësore në rreth njëqind e nëntëdhjetë e pesë seanca (195) përfaqësime në të gjitha departamentet në të cilat KGjK ka qenë palë e paditur, ose palë paditëse. Janë hartuar pesë dhjetë e dy (52) përgjigje në padi, mbi tridhjetë e tri (33) ankesa të ushtruara ndaj vendimeve të shkallës së parë, prapësime të urdhrave përmbartimor, revizione, padi, parashtresa dhe kërkesa të ndryshme.

Duke marrë parasysh situatën e krijuar nga COVID-19, Departamenti Ligjor ka përfaqësuar KGjK-në të gjitha seancat gjyqësore, duke mos përjashtuar këtu edhe Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Ka kryesuar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGjK-së, gjatë vitit 2020 dhe ka hartuar njëzet e katër (24) vendime lidhur me ankesat e palëve, si dhe një (1) përgjigje.

Gjithashtu, ky Departament ka hartuar dyqind e nëntëdhjetë e nëntë (299) vendime të nxjerra nga Këshilli. Ka pranuar për afërsisht dyqind (200) shkresa-parashtresa nga qytetar, avokat, institucione dhe OJQ të ndryshme drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të cilët kanë pas të bëjnë kryesisht rreth çështjes së procedurave ligjore, pretendimeve për sjellje të pahijshme ndaj gjyqtareve dhe për të gjitha këta shkresa/parashtresa është dhënë përgjigje, opinione ligjore, etj.

4.1.3 Departamenti për Buxhet dhe Financa

Departamenti për Buxhet dhe Financa në kuadër të Sekretariatit të KGjK-së, fushë veprimtaria e të cilit bazohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, Ligjin vjetor të Buxhetit, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjin për Gjykata, pastaj në Qarkoret Buxhetore, Rregulloret, Udhëzimet nga Departamenti i Thesarit dhe i Buxhetit në Ministrinë e Financave si dhe në Rregulloret, Udhëzimet dhe Vendimet e brendshme të KGjK/SKGjK-së, gjatë vitit 2020 ka arritur të realizoj dhe përfundoj këto punë të prezantuara shkurtimisht:

- Ekzekutimi i buxhetit të KGjK-së sipas ndarjeve buxhetore në Ligjin Nr.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës Për Vitin 2020, Rishikimit të buxhetit sipas ligjit Nr.07/L-014 si dhe sipas ndryshimeve buxhetore të ndodhura gjatë vitit;
- Përgatitja e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2021-2023 sipas Instruksionit për përgaditjen e KASH-it nga Ministria e Financave, në bashkëpunim me Departamentet tjera të SKGjK-së;
- Planifikimi i buxhetit 2021-2023 sipas qarkoreve buxhetore 2021/01, 2021/02 në bashkëpunim me gjykatat dhe shërbimet tjera të KGjK/SKGjK;
- Përgatitja e kërkesave buxhetore 2021-2023 për analizim dhe shqyrtim nga Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i KGjK-së. Sipas rekomandimit të këtij komisioni, dhe aprovimit nga Këshilli, kërkesat i janë dërguar Kuvendit, Qeverisë dhe Ministrisë së Financave të nënshkruara nga Kryesuesi i Këshillit;
- Është zotuar dhe shpenzuar buxheti për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, shpenzimeve komunale, subvencioneve dhe transfereve si dhe shpenzimeve kapitale sipas planifikimit buxhetor dhe sipas kërkesave nga shërbimet tjera të KGjK/SKGjK dhe nga gjykatat;
- Janë regjistruar të gjitha transaksionet në regjistrin e Kontabilitetit të Thesarit (SIMFK) si dhe është mbajtur evidenca kontabël në formatin e raportimit sintetik dhe analitik në Sekretariatit e KGjK-së;
- Përgatitja e raporteve mujore financiare të buxhetit dhe të hyrave të cilat janë dërguar tek Kryesuesi i Këshillit, Drejtori i SKGjK-së, si dhe raporte të shërbimeve tjera të KGjK/SKGjK-së;
- Përgatitja e raporteve mujore për obligimet e papaguara si dhe janë dërguar tek Thesari në Ministrinë e Financave (MF);
- Përgatitja e raporteve për barazimin tremujor të hyrave dhe shpenzimeve si dhe janë dërguar tek Thesari në MF;

- Përgatitja e pasqyrave vjetore financiare të KGjK-së sipas Rregullores së MF- Nr.01/2017 për “Për Raportim Vjetor Financiar të Organizatave Buxhetore” dhe udhëzimeve nga Departamenti i Thesarit në MF;
- Modifikimi i Softuerit për Menaxhimin Elektronik të Hyrave (SEMH) për t’u përshtatur kërkesave dhe nevojave të gjykatave;
- Monitorimi i punës së gjykatave për buxhet dhe financa, rreth zbatimit në këtë fushë të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2019, “Për ndarjen e Përgjegjësive të SKGjK-së dhe gjykatave në çështjet e personelit, buxhetit dhe financave, logjistikës dhe prokurimit”;
- Bashkëpunimi me auditorët e brendshëm dhe të jashtëm si dhe monitorimi i planit të veprimit për auditimin e vitit 2019. Monitorimi dhe përgatitja e raportit periodik për zbatimin e rekomandimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA);
- Përgatitja e Pyetësorit të Vetëvlerësimit dhe Regjistrit të Rreziqeve për KGjK dhe dërgimi i tyre në MF;
- Modifikimi i softuerit “E-pasuria” nga MAP si dhe është bërë i qashtë për përdorim nga të gjitha gjykatat.

4.1.4 Departamenti i Statistikës

Departamenti i Statistikës, gjatë vitit 2020 ka përpunuar dhe përpiluar këto raporte statistikore:

- Raporti i përgjithshëm statistikor për Tremujorin e I-rë 2020, është përfunduar në fund të muajit prill 2020;
- Raporti i përgjithshëm statistikor për Tremujorin e II-të dhe Gjashtëmujorin e I-rë 2020, është përfunduar në fund të muajit korrik 2020;
- Raporti i përgjithshëm statistikor për Tremujorin III-të dhe Nëntëmujorin e vitit 2020, është përfunduar në fund të muajit tetor 2020;

- Raporti i përgjithshëm statistikor vjetor - 2020, është përfunduar në muajin janar 2021;
- Për Komisionin për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve, janë kompletuar dosjet me të dhënat statistikore për 36 muaj për tetëdhjetë e pesë (85) gjyqtarë;
- Lëndët e vjetra të gjykatave, Tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2020;
- Raportet statistikore për vepra penale që kanë të bëjnë me korrupsion, Tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2020;
- Raportet e rregullta për Ministrinë e Integritetit Evropian, Tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2020;
- Raportet e rregullta për Ministrinë e Punëve të Brendshme për veprën penale Trafikim me Njerëz, Tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2020;
- Raportet e rregullta për Ambasadën Amerikane për veprën penale Trafikim me Njerëz, Tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2020;
- Raportimi i rregullt në “Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin” për Tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2020;
- Raportimi i rregullt në OSCE, për Tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2020;
- Raportimi i rregullt zyrtarëve të EULEX-it, për Tremujorin I, II, III dhe IV-të për vitin 2020;
- Raportimi i rregullt për të gjithë gazetarët e akredituar si dhe OJQ-ve të akredituara.

4.1.5 Departamenti i Logjistikës

Raporti për vitin 2020, adreson çështjet që ndërlidhen me shërbimin që ofron Departamenti i Logjistikës përfshirë këtu projektet kapitale, si: furnizimin me material të administrativ për KGJK dhe gjykata dhe shërbimet e ofruar të transportit për krijimin e kushteve të mira për operim të gjykatave në punën e tyre. Gjithashtu, janë realizuar kërkesat e gjykatave për investimet kapitale që lidhen me riparimet e nevojshme të objekteve dhe ndërtimi e objekteve të reja për gjykata. Po ashtu, vëmendje e veçantë i është kushtuar krijimit të kushteve për futjen në përdorim të versionit të ri të aplikacionit elektronik E-pasuria për gjithë zyrtaret e logjistikës në gjykata.

Investimet Kapitale, riparimi i objekteve ekzistuese dhe ndërtimi i objekteve të reja

Sipas kërkesave të gjykatave, kemi investuar në riparim dhe mirëmbajtje në dymbëdhjetë (12) objekte të gjykatave. Vlera e investimit arrin rreth 115.474,71€. Në kuadër të këtyre investimeve janë kryer punë në ljerjen e brendshme dhe të jashtme të gjykatave, krijimin e zyrave të reja nëpër objekte të gjykatave varësisht prej hapësirave. Rregullimi i ndriçimeve brenda dhe jashtë objekteve etj.

Ndërsa, ndërtimi i objekteve të reja ka qenë fillimi i ndërtimit të objektit të Gjykatës në Fushë Kosovë. Vlera totale e investimit për këtë fazë në ndërtimin e objektit të kësaj Gjykate ka qenë 194287.01€. Punimet në ndërtimin e këtij objekti për fazat e tjera janë në vazhdim e sipër.

Furnizimet me material, pajisje dhe inventar nëpër gjykata

Kemi arritur t'i përmbushim kërkesat dhe nevojat e gjykatave dhe KGjK-së me material zyrtar dhe material te shtypur dhe materialet e tjera të nevojshme. Për këto furnizime janë shfrytëzuar kontratat e KGjK-së dhe kontratat e Agjencisë Qendrore të Prokurimit. Janë përmbushur kërkesat për furnizimin me inventar dhe shërbime tjera për zyrtaret brenda KGjK-së dhe gjykatave. Totali i shpenzimeve të furnizimit dhe shërbimeve të KGjK-së dhe gjykatave gjatë vitit 2020 është.

- Furnizimi me inventar është 66,652.60€
- Mirëmbajtje te klimave dhe sistemeve të klimatizimit është 13,287.48€
- Mirëmbajtja e ngrohja qendrore ne objektet te gjykatave është 17,705.00€

Përdorimi i aplikacionit e-pasuria, versioni i ri

Nga Ministria e Punëve të Brendshme është prezantuar versioni i ri i aplikacionit e-pasuria, me ç' rast jemi detyruar të gjitha institucionet e Kosovës, përfshirë edhe KGjK, që të fillojmë të përdorim këtë version. Tani secili zyrtar përgjegjës në gjykatë ka filluar të përdorë versionin e ri, konkretisht kanë filluar t'i regjistrojnë të dhënat e sakta në aplikacionin e-pasuria.

Shërbimet në transport dhe mirëmbajtje të veturave

Në KGjK dhe gjykata gjatë këtij viti kemi pasur në shfrytëzim gjithsej, njëqind e dyzet e dy (142) automjete. Prej tyre i kemi pesëdhjetë e tri (53) vetura të marra me qira përmes kontratës së Agjencisë Qendrore të Prokurimit. Prej këtyre automjeteve, dymbëdhjetë (12) vetura të vjetra janë larguar nga përdorimi në gjykata dhe janë shitur. Raporti i shpenzimeve te automjeteve është vetëm për nëntëmujorin e vitit 2020, sepse për tremujorin e fundit, ende nuk kanë arritur raportet nga gjykatat. Vlera totale e shpenzimeve të krijuara nga automjetet e KGjK-së dhe gjykatave për nëntëmujorin e këtij viti është 338.000,00€.

Prej këtyre shpenzimeve kemi:

- 200,352.00 janë shpenzimet e qirasë së veturave (vjetore);
- 5,143.00 janë shpenzimet e auto gomave;
- 52,00.00 € janë shpenzimet e servisimit dhe të mirëmbajtës;
- 80,529.00€ janë shpenzime të karburanteve për vetura.

Shpenzimet mesatare të karburantit të veturave për 100 km është 7.2 litra.

Raportet e pranimit në Free Balance

Raportet e pranimit të regjistruara në Free Balance për lëndët të cilat dalin nga kontratat me procedura të prokurimit, gjatë vitit 2020 kanë qenë rreth treqind (300) lëndë të regjistruara.

4.1.6 Departamenti i Auditimit të Brendshëm

Departamenti i Auditimit të Brendshëm (DAB), duke u mbështetur në planin vjetor për vitin 2020, ka përfunduar të gjitha auditimet e planifikuara, siç janë:

- Menaxhimi i transportit;
- Menaxhimi i pasurive jo financiare;
- Menaxhimi i proceduarave të rekrutimit dhe kontratat me shërbime të veçantë;
- Menaxhimi i proceduarave të prokurimit në mallra, shërbim dhe punë;
- Menaxhimi i shpenzimeve të gjeneratorëve dhe mirëmbajtja e tyre;
- Menaxhimi i shpenzimeve dhe mirëmbajtja e pajisjeve të TIK-ut.

Departamenti i Auditimit të Brendshëm, ka hartuar dhe ka dorëzuar brenda afatit të caktuar Planin strategjik të auditimit të brendshëm për periudhën 2020-2022 dhe Planin vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2020. Të gjitha auditimet e brendshme janë zhvilluar në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe me qëllim të realizimit të objektivave të institucionit dhe të DAB,

që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe me përmirësimin e efikasitetit në punë, me shmangien e gabimeve të mundshme, me rritjen e vlerës dhe me raportimin e parregullsive dhe gabimeve me qëllim të shtimit të kontrollit, që të ofrojë siguri tek menaxhmenti për funksionim efikas në gjykata dhe departamentet përkatëse.

Në vazhdimësi janë bërë vizita përcjellëse për efikasitetin e sistemeve të menaxhimit dhe të funksionimit të kontrollit të brendshëm, si dhe të zbatimit të rekomandimeve nga Auditori i Brendshëm dhe nga Auditori i Përgjithshëm. Departamenti i Auditimit të Brendshëm ka realizuar planin për vitin 2020 dhe ka bërë përcjelljen për zbatimin e rekomandimeve. Komiteti i Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2020, ka mbajtur takime dhe siguron mbikëqyrje të planeve, raporteve dhe implementimit të rekomandimeve të dhëna nga auditorët.

4.1.7 Zyra për Teknologji Informative dhe Komunikim

Këshilli Gjyqësor i Kosovës përkundër gjendjes së krijuar me pandeminë Covid-19, gjatë vitit 2020 ka vazhduar me sukses implementimin e Projektit SMIL dhe aktiviteteve të parapara për këtë vit. Përveç disa vonesave të shkaktuara për shkak të pandemisë, projekti ka arritur që me sukses të implementoj aktivitet kryesore të parapara në projekt.

Në bazë të planit të punës së Projektit dhe aktiviteteve të planifikuara për vitin 2020, është vazhduar me trajnimet dhe ofrimin e asistimit për përdoruesit e sistemit SMIL në gjykata.

Projekti SMIL me sukses ka arritur të implementoj këto aktivitete:

- Implementimi i Projektit SMIL për të lëmire civile, penale dhe kundërvajtje është bërë në të gjitha gjykatat themelore. Trajnimet në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për përdorimin e sistemit të SMIL janë në fazën përfundimtare. Deri më tani janë realizuar deri në 80% e trajnimeve të stafit dhe i tërë procesi pritët të përfundojë gjatë muajit shkurt 2021;

- Pas regjistrimit të të gjitha lëndëve të vjetra civile dhe penale vitin e kaluar në gjykatat themelore, në Gjykatën e Apelit ka përfunduar në tërësi regjistrimi i lëndëve të vjetra në sistemin SMIL, me që rast në Gjykatën e Apelit janë regjistruar në tërësi 7,400 lëndë të vjetra civile dhe penale. Po ashtu, KGjK, ka nxjerrë vendim që nga data 1 janar 2020, raportet statistikore të bëhen në mënyrë elektronike, përmes sistemit SMIL;
- Është bërë instalimi i rrjetit kompjuterik në Degën e Gjykatës Themelore të Mitrovicës në Leposaviq dhe Zubin Potok. Gjithashtu, është bërë edhe trajnimi i stafit për përdorimin e SMIL, me këtë hap është mundësuar që edhe stafi i këtyre gjykatave të ketë qasje në sistem dhe të mund të realizojë veprimet me lëndë përmes SMIL;
- Me datë 22 qershor 2020, Këshilli së bashku me Projektin SMIL, filluan pilotimin e largimit të regjistrave manual nga përdorimi në Gjykatën Themelore Ferizaj. Pas përfundimit të pilotimit me sukses të këtij aktiviteti, KGjK me datë 7 dhjetor 2020, ka aprovuar planin me afatet kohore për largimin gradual të të gjithë regjistrave manual nga përdorimi, në të gjitha gjykatat. Ky proces, konsiderohet një hapi i madh në drejtim të digjitalizimit të punës së gjykatave dhe largimit të letrave nga përdorimi dhe pa dyshim se do të ketë efekt pozitiv në drejtim të rritjes së efikasitetit të punës në gjykata, llogaridhënies, transparencës si dhe do të përmirësimin të shërbimeve për palë;
- Shpërndarja automatike e lëndëve është një aktivitet tjetër i rëndësishëm së lartë për gjyqësorin në Kosovë, aktivitet ky i cili është implementuar me sukses në të gjitha gjykata themelore dhe degët e tyre. Pilotimi i këtij funksioni ka filluar më 18 shkurt 2020, me që rast KGjK, me datë 29 janar 2020, ka aprovuar dokumentin për caktimin e kriterëve për shpërndarjen automatike të lëndëve në gjykata;
- Një arritje tjetër e rëndësishme është edhe ndërlidhja elektronike ndërmjet prokurorisë dhe gjykatës, e cila fillimisht është pilotuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe Prokurorinë Themelore në Ferizaj me datë 22 gusht 2020, ndërsa me datë 30 shtator 2020, është bërë implementimi i ndërlidhjes elektronike për të gjitha prokuroritë dhe gjykatat themelore. Me rastin e implementimit të këtij aktivitetit tani më lëndët nga prokuroria në gjykatë transferohen në mënyrë elektronike;

- Me qëllim të rritjes së transparencës në sistemin gjyqësor të Kosovës, KGJK së bashku me Projektin SMIL, ka bërë ndërlidhjen e sistemit SMIL me ueb-portalin e Këshillit ku tani thirren të dhënat lidhur me lëndën dhe orari i mbajtjes së seancave gjyqësore thirren nga sistemi SMIL dhe shfaqen në ueb portalin e KGJK-së;
- Për mirëmbajtjen dhe avancimin e SMIL-it si dhe qendrës së të dhënave, me qëllimin për të realizuar procedura të përbashkëta të prokurimit, KGJK dhe KPK, më 9 mars 2020, kanë nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit. Të gjitha procedurat e prokurimit janë realizuar dhe nga janari i vitit 2021, KGJK dhe KPK do të marrin përsipër financimin e mirëmbajtjes dhe avancimin e SMIL-it i cili deri në 31 dhjetor 2020 është financuar nga donatori i projektit.

4.1.8 Zyra e Prokurimit

Sipas planit të prokurimit për vitin 2020, Zyra e Prokurimit ka përgatitur Raportin e Kontratave Publike të nënshkruar për punë/shërbime/furnizim për Këshillin Gjyqësor Kosovës, me njësitë e saj dhe për të gjitha nivelet e gjykatave.

Proceduarat dhe llojet e kontratave të nënshkruara

- Kontrata me procedurë te negociuar dy (2);
- Kontrata me vlerë të madhe një (1);
- Kontrata me vlerë të mesme tetëmbëdhjetë (18);
- Kontrata me vlerë koetimit katër (4);
- Kontrata me vlerë minimale tri (3).

Kontratat e nënshkruara sipas procedurave

- Furnizimi dhe montimi i Klimave për SKGjK dhe Gjykata;
- Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve për Gjykatën Themelore në Prizren me degët e saj dhe Gjykatën Themelore në Gjakovë me degët e saj;
- Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve për Gjykatën Themelore në Mitrovicë, dhe degët e saj;
- Servisimi dhe mirëmbajtja e gjeneratorëve në gjykata;
- Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Këshillit me njësitë e tij, Gjykatës Supreme, me Dhomën e Posaçme, Gjykatës së Apelit, me degën e saj në Mitrovicën Veriore dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë me degët e saj;
- Furnizimi me material të shtypur për gjykata dhe KGjK;
- Punime shtesë për ndërtimin e Gjykatës në Fushë Kosovë;

- Dezinfektimi i objektit të SKGjK-së, dhe të niveleve të gjykatave;
- Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të IT-së;
- Mirëmbajta dhe përmirësimi në Softuerin për të Hyrat Gjyqësore;
- Servisimi dhe mirëmbajtja e sistemit të shuarjes automatike të zjarrit (aerosol) dhe aparateve kundër zjarrit në gjykata dhe SKGjK;
- Servisimi emergjent i automjeteve të Gjykatës së Apelit;
- Kontrollimi teknik për automjetet e KGjK-së dhe gjykatave;
- Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve për Gjykatën Themelore në Gjilan me degët e saj dhe Gjykatën Themelore në Ferizaj me degët e saj;
- Sigurimi i auto përgjegjësisë për automjetet e KGjK-së dhe gjykatave;
- Sigurimi fizik i personelit dhe objektit të SKGjK-së;
- Servisimi dhe mirëmbajtje e ashensorëve në objektet e gjykatave dhe KGjK-së;
- Servisimi dhe mirëmbajtja e kamerave në objektet e gjykatave dhe KGjK-së;
- Shërbimet e televizionit kabllorik dhe internetit për KGjK-në;
- Dezinfektimi i Objektit të Gjykatës Themelore në Prizren dhe Objektin e Kundërvajtës në Prizren;
- Dhënia në shfrytëzim e hapësirave brenda objektit të KGjK-së për shërbim me pije;
- Dezinfektimi i objekteve të gjykatave dhe KGjK-së;
- Blerja e pajisjeve të TI-së për SKGjK dhe gjykata;
- Pastrimi i veturave të KGjK-së dhe gjykatave;
- Shërbime backup të rrjetit ËAN;
- Licenca të fireëall;
- Blerjen e licencave për aplikacionin për mbajtjen e seancave online për gjykatat themelore;
- Dezinfektimi i objekteve të gjykatave dhe SKGjK-së;
- Furnizimi me pajisje dezinfektuese për gjykata dhe SKGjK.

4.1.9 Zyra për Evidencë Penale

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, gjatë vitit 2020, ka vazhduar aktivitetet në funksion të ngritjes dhe konsolidimit të Sistemit Qendror të Evidencës Penale të Kosovës - SQEPK (Regjistri Qendror i Evidencës Penale të personave të Dënuar). Zyra Qendrore e Evidencës Penale, pranë KGJK-së, ka ndër marrë disa aktivitete të cilat ishin të orientuara në drejtim të krijimit të parakushteve për fillimin e funksionalizimit sa më të shpejtë të Sistemit të Centralizuar të Evidencës Penale. Edhe këtë vit, procesi i konsolidimit të SQEPK-së, u zhvillua në partneritet të ngushtë me Zyrën e BE-së në Kosovë, e cila është duke e zhvilluar projektin tre (3) vjeçar të asistencës pranë KGJK-së.

KGJK ka zhvilluar procesin e ngritjes së kapaciteteve të rregullta njerëzore dhe teknike në të gjitha gjykatat themelore dhe degët e tyre, ka vazhduar procesin e regjistrimit të lëndëve të reja penale në SQEP, si dhe ka intensifikuar aktivitetet në funksion të konsolidimit të bazës ligjore dhe administrative me qëllim të funksionalizimit të shpejtë të SQEP-së.

Zyra Qendrore e Evidencës Penale, gjatë kësaj periudhe ka realizuar këto aktivitete kryesore:

- Përfundimi i procesit të digjitalizimit të të gjitha lëndëve të vjetra penale, të cilat i referohen periudhës nga viti 1999-2019;
- Zhvillimi dhe finalizimi i procesit të emërimit të resurseve të nevojshme njerëzore në gjykatat e vendit me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së sistemit, në të gjitha gjykatat themelore dhe degët e tyre përkatëse, është bërë emërimi, ri caktimi dhe trajnimi i zyrtareve të rregullt të gjykatave, të cilët do të jenë kompetent për procedimin në sistem të lëndëve të reja penale;
- Nga data 01.01.2020 në të gjitha gjykatat themelore në nivel vendi, ka filluar dhe është vazhduar procesi i regjistrimit të lëndëve të reja penale (lëndëve të përfunduara me aktgjykime të plotfuqishme gjyqësore) në data bazën qendrore të SQEP-së;

- Vazhdimi i procesit të ngritjes dhe ndërtimit të Data Bazës Qendrore të Evidencës Penale, kjo Bazë e të dhënave është duke u ndërtuar duke marrë për bazë standardet e fundit të Teknologjisë informative dhe e njëjta tani është operative në të gjitha gjykatat e vendit;
- Në funksion të implementimit të SQEP-së, KGJK me datë 29.05.2020, aprovoi format e reja të certifikatave të gjendjes penale, të cilat do ti procedoj SQEP dhe sistemi i ri i certifikatave të gjendjes penale do të filloj të zbatohet gjatë pjesës së parë të vitit 2021;
- ZQEP, gjatë këtij viti ishte pjesë aktive e procesit të hartimit të koncept dokumentit mbi evidencën qendrore penale dhe ligjit të ri mbi SQEP, ku procesi është duke u udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë dhe ligji pritet të aprovohet gjatë vitit 2021;
- Edhe këtë vit u pranuan raportet e rregullta nga Departamenti për bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar pran Ministrisë së Drejtësisë, lidhur me personat e dënuar me shtetësi kosovare nga gjykatat e shteteve tjera;
- ZQEP, edhe këtë vit ka realizuar një bashkëpunim të ngushtë me institucionet relevante shtetërore, si Ministrinë e Drejtësisë, MPB, Agjencinë e Regjistrimit Civil, Ministrinë e Administratës Publike, e të tjera, në funksion të realizimit të mandatit të saj.

Situata Aktuale në Data Bazën Qendrore të Evidencës Penale

Në tabelën e mëposhtme, përfshihen disa të dhëna të përgjithësuara mbi gjendjen aktuale në data bazën e SQEP, si dhe disa informacione tjera të përgjithshme nga fushë veprimtaria e ZQEP-së.

1	Nr. total i rasteve në data bazë		288074
2	Nr. total i personave të dënuar në data bazë		211227
3	Nr. total i rasteve të procedura në data bazë		36790
4	Nr. total i personave të dënuar gjatë vitit 2020		19366
5	Nr. Individual i rasteve të evidentuara në gjykatat themelore, së bashku me degët e tyre (lëndë të regjistruara në vitin 2020)	Gj.Th. Prishtinë	9941
		Gj.Th. Prizren	4963
		Gj.Th. Ferizaj	4293
		Gj.Th. Pejë	5055
		Gj.Th. Gjilan	5672
		Gj.Th. Mitrovicë	2558
		Gj.Th. Gjakovë	4308
6		Nr. i regjistrave të evidencës të verifikuar	
7	Nr. i rasteve të pranuar nga DBJN/MD		364

Gjatë vitit 2021, Zyra Qendrore e Evidencës Penale planifikon të përmbyll disa prej aktiviteteve kryesore si:

- Të filloj operimin e plotë të Sistemit qendror të evidencës penale, me të gjithë komponentët e tij përbërës;
- Të përfundoj procesin e Verifikimit të të dhënave, dhe të bëjë pastrimin e regjistrit të të dhënave për personat e dënuar, të evidentuar në sistem qendror;

- Të vazhdoj forcimin e kapaciteteve të rregullta të gjykatave, me qëllim të mbarëvajtjes së procesit të regjistrimit të rregullt të lëndëve në sistem;
- Të filloj procesin e lëshimit të certifikatave të reja të gjendjes penale të bazuara në të dhënat e integruara të SQEP;
- Të filloj zbatimin e procesit të Rehabilitimit dhe fshirjes së dënimeve sipas standardeve dhe komfor dispozitave të Kodit Penal dhe Rregullores përkatëse mbi SQEPK-në;
- Të përmbyllë procesin e tranzicionit dhe kalimin nga sistemi aktual i evidencës penale për në sistemin e ri;
- Të përmbyll procesin e bartjes së kompetencave në menaxhimin e SQEP-së, nga Projekti NCCR/BE në KGjK.

4.1.10 Integrimi Evropian

Procesi i integritimit evropian është një proces kompleks dhe kërkon përkushtim në implementimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit e cila siguron veprimet që duhet të ndërmerren për implementimin e kësaj marrëveshje. Një ndër prioritetet kyçe është edhe zbatimi dhe respektimi i plotë i sundimit të ligjit. Prandaj, duke pasur parasysh obligimet të cilat rrjedhin nga kjo marrëveshje, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është një ndër kontribuuesit kryesor dhe fundamental në procesin e Integritimit Evropian, në veçanti në sektorin e sundimit të ligjit.

KGjK me qëllim të zbatimit të MSA-së, si dhe përmbushjes së obligimeve, edhe përkundër ndikimit të rëndë të pandemisë COVID-19 në Kosovë e cila ka ndikuar edhe në punën e gjyqësorit, ka bërë përpjekje dhe me kohë ka ofruar raportime të rregullta mbi zhvillimet në sistemin e drejtësisë si dhe ka ndërmarrë masat e duhura për përmbushjen e këtyre obligimeve dhe realizimin e reformave në sistemin gjyqësor, duke ofruar mbështetje në bashkërendimin e të gjitha aktiviteteve si dhe përmbushjen e rekomandimeve të cilat i përkasin fushës së gjyqësorit dhe ndërlidhen me integritet evropianë.

Po ashtu, KGjK ka pasur bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjitha projektet të cilat mbështesin KGjK-në në drejtim të ngritjes së efikasitetit të sistemit gjyqësor si dhe sigurimit të një gjyqësori të pavarur dhe transparent, mbështetje e cila në vazhdimësi ofrohet nga partnerët ndërkombëtar.

4.1.11 Zyra për Mbështetje dhe Përkthime

Zyra për përkthime dhe mbështetjen e KGjK-së ka përkthyer të gjitha materialet që ka pranuar si: vendime, akte normative, rregullore, udhëzime, agjenda, njoftime, komunikata për media, raporte të ndryshme të departamenteve, zyrave dhe njësive brenda SKGjK-së.

Ka ofruar përkthim simultan dhe konsektiv në të gjitha takimet e Këshillit, komisionet e tij, si dhe në komisionet intervistuese për gjyqtarë. Përmes operatorit teknik, zyra ka mirëmbajtur pajisjet dhe ka siguruar ruajtjen e procesverbaleve dhe të gjitha akteve që nxirren nga Këshilli në mënyrë elektronike. Gjithashtu, ka mirëmbajtur orarin e mbajtjes së takimeve në sallën e KGjK-së, ka caktuar takime në platformat online dhe i ka monitoruar ato si dhe ka përgatitur materialin e mbledhjeve të Këshillit. Vlen të theksohet, se në vazhdimësi kemi mbështetur Këshillin në përkthimin e të gjitha materialeve dhe incizimin e takimeve.

Kjo Zyrë, ka shërbyer edhe si anëtare e rrjetit dhe e bordit për shërbime gjuhësore në kuadër të Zyrës së Komisionerit për Gjuhë (ZKGj). Gjatë vitit, nuk kemi pranuar asnjë ankesë prej qytetarëve për mosrespektimin e gjuhëve zyrtare nga gjykatat e Kosovë. Falë përkthimit të të gjitha materialeve në dy gjuhë zyrtare dhe publikimit të tyre, kjo zyre së bashku me Zyrën për Informim dhe Zyrën e IT-së janë shpërblyer sërish nga ZKGj në bashkëpunim me OSBE, me çmimin “*Praktika më e mirë në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve*”, bazuar në monitorimin e përdorimit të gjuhëve zyrtare në ueb portalin e KGjK-së dhe rrjetin social Facebook.

Ka organizuar edhe trajnime virtuale dhe individuale me përkrahjen e partnerëve ndërkombëtar si UNDP dhe GIZ për përkthyesit e të gjitha gjykatave të Kosovës dhe SKGJK-së, përmes të cilave është synuar rritja e cilësisë së përkthimeve dhe standardizimi i terminologjisë juridike gjyqësore të përkthimeve. Po ashtu, janë ofruar trajnime individuale për përdorimin e aplikacioneve softuerike që mundësojnë përkthim më të shpejtë dhe më cilësor të dokumenteve. Zyra është e angazhuar maksimalisht edhe në mbështetjen e Këshillit në organizimin dhe përpilimin e listave për anëtarë të Komisionit Vlerësues për Përkthyes dhe Interpret Gjyqësor dhe do të vazhdoj përkrahjen ndaj Komisionit në certifikimin e përkthyesve dhe interpretëve gjyqësorë

4.1.12 Komunikimi me Publikun

Komunikimi me publikun, siguron transparencë dhe qasje publike për punën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më konkretisht të Sekretariatit të Këshillit, duke ofruar informata të nevojshme dhe qasje në dokumentet publike me kërkesë të qytetarëve dhe mediave.

Viti 2020, ka qenë mjaft sfidues për tërë sistemin e drejtësisë, andaj, shumica e takimeve janë mbajtur online. Të gjitha aktivitetet e kryesuesit i mbështesim në vazhdimësi, duke përpiluar, ftesa, njoftime, sqarime, reagime, komunikata, të cilat publikohen ueb faqe, rrjetin social Facebook dhe media. Gjatë vitit 2020, janë publikuar gjithsej, njëqind e tridhjetë e një (131) komunikata dhe njoftime.

Kemi vazhduar përditësimin e ueb faqes së gjyqësorit, e cila i është përshtatur mirë përdoruesve dhe publikut, në qasjen e informatave të nevojshme si dhe mirëmbajtjen dhe përditësimin e faqes zyrtare të KGJK-së në rrjetin social Facebook. Në bashkëpunim me projektet e USAID, kemi publikuar video shpjeguese për publik lidhur me informata dhe shërbime brenda gjykatave, grafika dhe raporte të ndryshme. Po ashtu, kemi realizuar edhe video drejtpërdrejtë në rrjetin social Facebook në organizime më të rëndësishme.

Përveç kërkesave të vazhdueshme të mediave të shkruara dhe vizuale, ne iu kemi përgjigjur me korrektësi të gjitha OJQ-ve që punojnë dhe veprojnë në Kosovë, të cilat kanë monitoruar punën e gjyqësorit, në veçanti punën e gjykatave.

Kemi vazhduar mbështetjen e të gjitha organizatave joqeveritare, duke filluar nga GLPS, Lëvizja Fol, BIRN, ATRC, IKD, KDI, Çohu, etj. Për shkak të Pandemisë COVID-19, shumica e aktiviteteve të komunikimit me media nuk jam përmbushur, përfshirë këtu edhe Konferencën Vjetore Gjyqësore. Zyra e Komisionerit për gjuhët (ZKGJ) në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE), komisioni vlerësues shpërbleu Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGjK) sërish me çmimin “Praktika më e mirë në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve”, në vlerësim të përpjekjeve për forcimin e zbatimit të të drejtave gjuhësore në Kosovë. Ky çmim është bazuar në monitorimin e përdorimit të gjuhëve zyrtare në ueb faqen e KGjK-së dhe rrjetin social Facebook.

4.1.13 Certifikuesi

Deri në fund të vitit 2019, nga Departamenti për Buxhet dhe Financa janë pranuar 1680 lëndë, në shumë prej 1,622.120.49€ dhe të gjitha janë aprovuar, asnjë obligim nuk është bartur për vitin 2020.

Numri i lëndëve të pranuar në zyrën e Certifikuesit është, 1389 lëndë në shumë prej 1,942,372,18€ dhe të gjitha lëndët e pranuar janë aprovuar, kështu që nuk kemi obligime të bartura nga viti 2020 për vitin 2021. Numri i lëndëve pritët të rritet prapë në këtë vit, kjo për shkak se, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka vendosur që lëndët të cilat kërkojnë procedurë të prokurimit të kthehen nga të gjitha nivelet e gjykatave të Kosovës dhe të menaxhohen nga KGjK.

5.0 PANELI I LIRIMIT ME KUSHT

Paneli për lirim me kusht, gjatë vitit 2020 ka organizuar mbajtjen e seancave të Panelit për lirim me kusht dhe kontrollimin e rasteve për kualifikim për shqyrtim për lirim me kusht. Në këtë periudhë, Paneli ka mbajtur gjithsej, pesëdhjetë e një (51) seanca dhe vëmendje e posaçme i është kushtuar afateve ligjore të shqyrtimit të rasteve. Për çdo muaj janë mbajtur seancat dhe janë shqyrtuar dhjetë (10) deri në pesëmbëdhjetë (15) raste, me qëllim të respektimit të afateve ligjore. Pra, është organizuar numër i mjaftueshëm i seancave për të respektuar të drejtën e të burgosurve për një shqyrtim në afat të arsyeshëm kohor.

Parimi, se personi i dënuar mund të lirohet me kusht gjendet në nenin 90 të KPRK-së, në dispozitën e nenit 90 par. 2 të këtij kodi parashihet që: “Personi i dënuar për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me të paktën pesë (5) vjet burgim, mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur dy të tretat (2/3) e dënimit të shqiptuar për vepra tjera penale, personi i dënuar mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur gjysmën e dënimit të shqiptuar”. Për personat e dënuar me burgim për të mitur, zbatohen dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të mitur. Pra, lirimi me kusht sipas dispozitave të ligjit është një mundësi dhe jo një masë që duhet të pranohet në mënyrë automatike.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka vëzhguar dhe monitoruar procedurat e implementimit të lirimimit me kusht në të gjitha fazat e procedurës. Në pajtim me ligjin dhe Marrëveshjet e Bashkëpunimit, PLK ka ofruar qasje dhe bashkëpunim për OJQ-të të cilat monitorojnë zbatimin e lirimimit me kusht. Gjithashtu, vlen të përmendët, se nga data 1 mars 2019, Institucionet Korrektuese i parashirojnë dosjet në mënyrë elektronike dhe kjo ka ndikuar në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit si dhe transparencës. Ky panel ka pasur në punë tetëqind e tridhjetë e një (831) raste, prej tyre shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë (796) raste janë pranuar nga Institucionet Korrektuese në vitin 2020 dhe tridhjetë e pesë raste (35) janë bartur nga viti 2019, gjithsej, prej tyre nga Paneli janë shqyrtuar shtatëqind e gjashtëdhjetë (760) raste për lirim me kusht, prej tyre:

- Me aktvendim lirues janë dyqind e tetëdhjetë e një (281) raste;
- Me aktvendim refuzues janë katërqind e njëzet e gjashtë (426) raste;
- Janë pushuar procedurat e shqyrtimit për lirim me kusht për tridhjetë e pesë (35) raste, për arsye të lirimit të parakohshëm nga ana e Gjykatave Themelore;
- Është hedhur poshtë shqyrtimit i kërkesave për gjashtëmbëdhjetë (16) raste;
- Ndërsa, janë shtyrë dy (2) raste për shqyrtim në seancën e fundit të vitit 2020.

Gjithashtu, shtatëdhjetë e një (71) rastet e pranuar pas datës 2 dhjetor 2020, janë bartur për shqyrtim në vitin 2021. Numri i kërkesave të shqyrtuara sipas gjinisë është shtatëqind e dyzet e gjashtë (746) meshkuj, ndërsa katërmëdhjetë (14) femra. Në këtë vit, Paneli ka trajtuar edhe kërkesa të personave të dënuar me burgim për të mitur.

Sipas ligjit, refuzimi i një kërkesë për lirim me kusht nuk konsiderohet përfundimtar meqë ligji në fuqi ka paraparë që me rastin e refuzimit të kërkesës për lirim me kusht të caktohet edhe rishqyrtimi, si një masë për t'i dhënë motiv personit të dënuar për rehabilitim dhe risocializim, me synim të ri integritet të tij/saj në familje dhe rrethin shoqëror. Periudha kohore për rishqyrtimin e kërkesave caktohet në aktvendimin e Panelit për lirim me kusht dhe kërkesa për rishqyrtim nuk mund të parashtrohet më herët se tre (3) muaj, por jo edhe me gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj prej konsiderimit paraprak.

Ndërsa, personave të dënuar të cilëve i aprovohet kërkesa për lirim me kusht, ndaj tyre caktohet masa e mbikëqyrjes nga Paneli për lirim me kusht. Ekzekutimin e masës e realizon Shërbimi Sprovues i Kosovës, i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Ky shërbim i paraqet Panelit raporte fillestare, periodike dhe përfundimtare mbi ecurinë e mbikëqyrjes së personave të liruar me kusht. Gjatë këtij viti, kemi pranuar pesëqind e njëzet e dy (522) raporte të zyrtarëve sprovues dhe nuk ka pasur ndonjë vërejtje gjatë zbatimit të lirimit me kusht.

6.0 NJËSIA E INSPEKTIMIT GJYQËSOR

Njësia e Inspektimit Gjyqësor (NjIGJ) në zbatim të nenit. 36 dhe 37 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Rregullores nr. 04/2020 të KGJK-së për Autoritetin, Organizimin dhe Funksionimin e Njesisë për Inspektim Gjyqësor, në vlerësimin e punës së gjykatave, i ndihmon Komisionet e KGJK-së për Administrimin e Gjykatave dhe për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve, si dhe i propozon KGJK-së politika, apo udhëzime për reformimin dhe përmirësimin e punës së gjykatave.

NjIGJ, raporton te menaxhmenti i gjyqësorit deri në ç'masë janë zbatuar kornizat e caktuara ligjore, politikat dhe strategjitë e KGJK-së në sistemin gjyqësor. Kjo njësi, identifikon zbrazëtirat apo kundërthëniet ligjore, praktikat e mira në gjyqësor të cilat do të mund të zbatoheshin pa e dëmtuar kornizën ligjore të KGJK-së, kupton pengesat që paraqiten tek gjykatësit gjatë ushtrimit të detyrës si dhe përgatitë çdo informatë të kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

NjIGJ ka zhvilluar këto aktivitete të punës:

- Ka përfunduar Raportin e Inspektimit për mënyrën dhe numrin e lëndëve të kryera civile në Gjykatën Themelore të Gjilanit, për fushëveprimin prej 1 janarit 2019 deri më 30 qershor 2019;
- Ka përfunduar Raportin e Inspektimit të menaxhimit të përgjithshëm administrativ i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës;
- Ka përfunduar Raportin e Inspektimit për llojet dhe mënyrën e përdorimit të vulës së plotfuqishmërisë në Gjykatën Themelore të Prishtinës dega në Lipjan;
- Ka draftuar Udhëzimin Administrativ për zbatimin e Rregullores për Shenjat Unike për Klasifikimin e Dokumenteve dhe Afatet e Ruajtjes së tyre (e Ministrisë për Punë të Brendshme) nr. 05/2020;

- Në përkrahje të USAID/JSSP, ka draftuar Udhëzimin për mënyrën e zbatimit e Rregullores nr. 04/2020 të KGjK-së për Autoritetin, Organizimin dhe Funkcionimin e Njesisë për Inspektim Gjyqësor;
- Ka harmonizuar tabelën e lëndëve gjyqësore për arkivim sipas Rregulloren për Shenjat Unike për Klasifikimin e Dokumenteve dhe Afatet e Ruajtjes së tyre (e Ministrisë për Punë të Brendshme) nr. 05/2020;
- Njlgj nga trajnerët e TI-ve të SKGjK, është trajnuar për përdorim të programit SMIL lidhur me procedimin tekniko-administrativ të lëndëve gjyqësore;
- Ka ndihmuar dhe kryer sekretarinë në Komisionin e KGjK-së për Administrimin e Gjykatave në këto çështje:
 - Draft - Rregullore për Organizimin edhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave;
 - Draft - Plani i Veprimit për Menaxhimin e Krizës Emergjente;
 - Draft-Udhëzim Administrativ për Zbatimin të Orarit të Ruajtjes dhe Asgjësimit të të Dhënave Gjyqësore;
 - Koncept - Dokument për Bashkëpunëtorë Profesional;
 - Forma dhe Përmbajtja e Planit të Punës së Gjykatës Themelore;
 - Procedura Standarde e Veprimit për Praktikantët Gjyqësor.
- Ka ndihmuar dhe kryer sekretarinë në Komisionin e KGjK-së për Vlerësimin e Performancës së njëqind e njëzet e gjashtë (126) gjyqtarëve nga të tre nivelet gjyqësore të Kosovës;
- Rregullimi i Arkivit Portativ të Njlgj-it për vendosjen e lëndëve dhe materialeve të krijuara nga Komisionet e KGjK-së dhe dokumentacionit tjetër të Njlgj-it.

7.0 VLERËSIMI DHE VERIFIKIMI I GJYQTARËVE

Zyra për Vlerësim dhe Verifikim të Gjyqtarëve aktivitetin e saj e kryen komfor Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Këshillin Gjyqësor, Ligjin mbi Gjykatat, Rregulloreve dhe akteve tjera normative të aprovuara nga ana e KGJK-së dhe gjithnjë duke u bazuar në rekomandimet e KIEVIT për pavarësinë e Gjyqësorit në Evropën Lindore i cili është decidiv sa i përket kontrolleve të historikut personal dhe profesional të kandidatëve të mundshëm për gjyqtarë ku thotë: *“asnjë kontroll tjetër i historikut nuk mund të bëhet nga shërbimet tjera të sigurisë”*.

Për përuhdën raportuese, kjo zyrë ka paraqitur aktivitetet e përgjithshme të cilat ndërlidhen me trajtimin e kandidatëve të mundshëm të cilët kanë aplikuar në konkurset e shpallura nga ana e Këshillit për pozitën, gjyqtar në nivelin e gjykatave themelore dhe konkurset tjera të brendshme për ngritje në detyrë të gjyqtarëve. Gjithashtu, ka bërë edhe verifikimin e së kaluarës për kandidatët e Policisë së Kosovës dhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Qëllimi i kësaj zyre, është që të aplikoj një qasje dhe zbatim të drejtë në procesin e vlerësimit dhe verifikimit të kandidatëve duke përfshirë një proces të zgjeruar të vlerësimit dhe verifikimit të informatave të siguruar nga kandidatët dhe burimet tjera, të cilat ndërlidhen me historikun e së kaluarës së kandidatëve për pozitën për gjyqtar në sistemin gjyqësor të Kosovës. Përgjegjësitë e kësaj zyre janë fokusuar në shqyrtimin, analizimin, verifikimin, hetimin, përpilimin e raporteve me shkrim dhe sigurimin e të dhënave për kandidatët të cilët arrijnë t'i përmbushin kriteret formale për pozitën përkatëse, në mënyrë që të lehtësoj punën e Komisionit për Emërim dhe më qëllim që emërimet të bëhen sipas meritës.

Gjatë kësaj kohe, përpos bashkëpunimit në vijën e hierarkisë horizontale dhe vertikale në kuadër të KGjK-së, Zyra për Vlerësim dhe Verifikim Gjyqësor ka pasur një bashkëpunim edhe me institucionet tjera relevante, si: gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës, Policinë e Kosovës, Doganën e Kosovës, Agjencinë Kundër Korrupsionit, Agjencinë Kadastrale, Agjencinë për Regjistrimin e bizneseve, Agjencinë Kosovare të Pronës, Administratën Tatimore të Kosovës, komunat dhe ministritë e ndryshme (sipas nevojës), Odën e Avokatëve, Forcën e Sigurisë dhe Komisionin Qendror Zgjedhor, përmes të cilave ka siguruar dhe verifikuar informatat e duhura lidhur me kandidatët.

Konkursi për gjyqtarë të Gjykatave Themelore

KGjK, në përputhje me nenin 108, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me Ligjin mbi Gjykatat Nr:03/L-199 (të ndryshuar), Ligjin për Këshillin Nr.03/L-223 (të ndryshuar) dhe Rregulloren 05/2016 për rekrutimin, provimin emërimin dhe rrimërimin e gjyqtarëve i shpallur datë: 16.12.2018 deri më 31.12.2018 ku për njëzet e shtatë (27) pozita të hapura kanë aplikuar treqind e pesëdhjetë e katër (354) kandidatë. Në fazën fillestare, dy (2) kandidatë kanë dhënë dorëheqje. Komisioni për Rekrutim i KGjK-së, në takimin e mbajtur me datë 14 dhe 15 tetor 2019, ka bërë verifikimin e dokumentacionit të paraqitur ku u vendos se nga treqind e pesëdhjetë e dy (352) kandidatë, njëqind e gjashtëmbëdhjetë (116) kandidatë nuk i plotësojnë kriteret formale të kërkuara me konkurs. Komisioni për Rishqyrtim gjithsej ka pranuar, nëntëdhjetë e katër (94) ankesa të paraqitura kundër vendimit të komisionit në fjalë. Më datë 30 tetor 2019, ky Komision ka shqyrtuar ankesat e pranuar nga të cilat shtatëdhjetë (70) ankesa janë miratuar, ndërsa njëzet e katër (24) ankesa janë refuzuar.

Me 17 nëntor 2019, është mbajtur testi kualifikues në Akademinë Policore Vushtrri ku kanë marrë pjesë dyqind e pesëdhjetë e tetë (258) kandidatë. Nga treqind e gjashtë (306) kandidatët të cilët plotësonin kushtet, në bazë të Rregullores 05/2016, dhjetë (10) kandidatët që kanë të përfunduar

Programin Fillestar të Arsimimit Ligjor (PFAL) nuk janë paraqitur, ndërsa tridhjetë e tetë (38) kandidatë, për arsye të panjohura, nuk janë paraqitur në testin kualifikues. Nga dyqind e pesëdhjetë e tetë (258) kandidatë, testin kualifikues e kanë kaluar njëqind e njëzet e shtatë (127) kandidatë, ndërsa njëqind e tridhjetë e një (131) kandidatë nuk kaluan testin kualifikues.

Komisioni për Rishqyrtim ka pranuar gjithsej, tridhjetë e nëntë (39) ankesa të paraqitura kundër vlerësimit të Komisionit për rekrutim të testit kualifikues. Me datë 26 nëntor 2019, Komisioni për Rishqyrtim bëri shqyrtimin e ankesave të paraqitura me ç'rast një (1) ankesë është miratuar, ndërsa tridhjetë e tetë (38) janë refuzuar.

Komisioni për Rekrutim i KGjK-së me datë 08 dhe 09 shkurt 2020, organizoj mbajtjen e testit me shkrim në lëmin penale dhe civile në Akademinë Policore në Vushtrri. Nga njëqind e njëzet e tetë (128) kandidatë me të drejtë pjesëmarrje, prezent ishin njëqind e njëzet e pesë (125) kandidatë. Komisioni për Rekrutim i KGjK-së, me datë 12 shkurt 2020, bëri publikimin e listës së testit me shkrim me pesëdhjetë e dy (52) kandidatë të suksesshëm.

Komisioni ka pranuar gjithsej, tridhjetë e nëntë (39) ankesa të paraqitura kundër Komisionit për Rekrutim. Më datë 20 shkurt 2020, në takimin e mbajtur, Komisioni bëri shqyrtimin e ankesave dhe ka refuzuar tridhjetë e nëntë (39) ankesa. Intervistat u zhvilluan duke filluar nga 15.06.2020 – 01.07. 2020. Në intervistën me gojë, kanë qenë të ftuar gjashtëdhjetë e dy (62) kandidatë, përfshirë këtu edhe kandidatët të cilët kanë të përfunduar PFAL, por dy (2) kandidatë kanë dhënë dorëheqje dhe një (1) kandidat nuk është paraqitur fare në intervistë.

Komisioni për Rekrutim i KGjK-së, më 13 korrik 2020, bëri publikimin e listës me njëzet e shtatë (27) kandidatë të cilët kaluan provimin për gjyqtarë. Kundër vlerësimit përfundimtar, Komisioni ka pranuar gjithsej, njëmbëdhjetë (11) ankesa ku me datë 22.07.2020, ka shqyrtuar këto ankesa dhe të gjitha janë refuzuar. Bazuar në informacionet e pranuar nga institucionet e sipër cekura, rezultatet e arritura në testin kualifikues, me shkrim dhe intervistën me gojë, pikët e arritura dhe rezultatin përfundimtar i nxjerrë nga ana e Komisioneve të KGjK-së, Këshilli ka propozuar për emërim njëzet e shtatë (27) kandidatët e propozuar tek Presidenti i Republikës së Kosovës.

Konkurset e brendshme

Gjykata e Apelit - Divizioni i Mitrovicës

KGjK, në përputhje me nenin 104 dhe 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me Ligjin për Gjykatat Nr. 06/L-054, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës Nr. 06/L-55 dhe Rregullores (01/2014) për procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve (të ndryshuar dhe plotësuar) shpall konkurs të brendshëm për gjyqtar për Gjykatën e Apelit - Divizioni i Mitrovicës, një (1) pozitë e gjyqtarit nga radhët e komunitetit serb, konkurs i datës 16.04.2019, me vendim KGjK. Nr. 85/2019. Po ashtu, me datë 11.11.2019, me vendim KGjK. Nr. 226/2019, Këshilli, në përputhje me nenin 104 dhe 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me Ligjin për Gjykata Nr. 06/L-054, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës Nr. 06/L-55, dhe Rregullores (01/2014),

Për procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve (të ndryshuar dhe plotësuar) shpall konkurs të brendshëm për gjyqtar për Gjykatën e Apelit - Divizioni i Mitrovicës, një (1) pozitë e gjyqtarit nga radhët e komunitetit serb.

Paneli për shqyrtimin e aplikacioneve dhe Intervistim i themeluar me Vendim KGjK. Nr. 43/2020, në takimin e mbajtur me datë 06 mars 2020, bën shqyrtimin e aplikacioneve dhe vërteton se në konkursin e datës 16.04.2019, janë paraqitur dy (2) kandidatë dhe të dy (2) kandidatët i plotësojnë kushtet formale të kërkuara me konkurs. Ndërsa, në konkursin e shpallur të datës 11.11.2019, është paraqitur një (1) kandidatë (i cili është i njëjti kandidat që ka aplikuar në konkursin e mësipërm) me ç'rast Paneli për Shqyrtimin e Aplikacioneve dhe intervistim vërteton se i plotëson kushtet formale të kërkuara me konkurs.

Me datë 08.06.2020, pas përfundimit të Vlerësimit të Performancës janë zhvilluar intervistat e kandidatëve për ngritje në detyrë Gjyqtar, Gjykata e Apelit - Divizioni i Mitrovicës. Paneli për Shqyrtimin e Aplikacioneve dhe Intervistim, për pozitën e ngritjes në detyrë së gjyqtarit në

Gjykatën e Apelit - Divizioni i Mitrovicës rekomandoi dy (2) kandidatë për të dy konkurset e shpallura nga KGjK, dhe me miratimin e anëtarëve të KGjK, emërohen për pozitat e sipër cekura.

Gjykata e Apelit

KGjK, me datë 31.12.2019, ka marrë Vendim KGjK. Nr. 267/2019 që të aprovet pjesërisht kërkesa e Kryetarit të Gjykatës së Apelit për shpalljen e konkursit për tre (3) pozita të lira për gjyqtarë në Gjykatën e Apelit. Konkursi i brendshëm për gjyqtar është shpallur me 06.01.2020. Paneli për Shqyrtimin e Aplikacioneve dhe Intervistim i caktuar me Vendim KGjK. Nr. 46/2020, i datës 21.02.2020, në takimin e mbajtur me datë 06.03.2020 në KGjK, bëri shqyrtimin e aplikacioneve të njëzet e një (21) kandidatëve - gjyqtarë nga të cilët një (1) kandidat ka dhënë dorëheqje.

Paneli verifikon se të njëzet (20) kandidatët i plotësojnë kriteret e kërkuara me konkurs. KGjK, më datë 06.08.2020, ka marrë Vendim KGjK. Nr. 183/2020, dhe caktoi Komisionin për Rishqyrtim të ankesave të kandidatëve për ngritje në detyrë.

Pas përfundimit të Vlerësimit të Performancës, Paneli për Shqyrtimin e aplikacioneve dhe intervistim ka zhvilluar intervistat e kandidatëve për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, duke filluar me datë 14.07. 2020, deri më 17.07. 2020, derisa kandidatët të cilët ishin të prekur me COVID-19, janë intervistuar më datë 23.09.2020. Nga gjithsej kandidatët, njëmbëdhjetë (11) prej tyre janë paraqitur në intervistë, derisa tetë (8) prej tyre nuk janë paraqitur në intervistë dhe një (1) kandidat ka vdekur nga virusi COVID-19.

Për pozitën ngritje në detyrë në Gjykatën së Apelit të Kosovës, që sipas konkursit kërkohen tri (3) pozita, Paneli për Shqyrtimin e Aplikacioneve dhe Intervistim rekomandoi tre (3) kandidatët e listuar më pikë më të larta në listën përfundimtare dhe me miratimin e anëtarëve të KGjK-së emërohen për pozitat e sipër cekura.

Gjykata Supreme e Kosovës

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 13.12.2019, ka marrë Vendim KGjK. Nr. 238/2019 që të aprovet kërkesa e Kryetarit të Gjykatës Supreme për shpalljen e konkursit për tri (3) pozita të lira për gjyqtarë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Konkursi i brendshëm për gjyqtar është shpallur me 24.12.2019.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në bazë të Rregullores 01/2014, për Procedurën e Ngritjes në Detyrë të Gjyqtarëve dhe komfor Rregullores (06/2016), për ndryshimin e Rregullores (01/2014) me datë 21.02.2020 ka marrë Vendim KGjK. Nr. 46/2020 dhe caktoi Panelin për Shqyrtimin e Aplikacioneve dhe Intervistim.

Paneli për Shqyrtimin e Aplikacioneve dhe Intervistim me datë 06.03.2020, në takimin e mbajtur në KGjK, bëri shqyrtimin e aplikacioneve të trembëdhjetë (13) kandidatëve - gjyqtarë dhe verifikoi se të gjithë kandidatët i plotësojnë kriteret e kërkuara me konkurs.

Me datë 08.07.2020 dhe 09.07.2020, pas përfundimit të Vlerësimit të Performancës, Paneli për Shqyrtimin e aplikacioneve dhe Intervistim ka zhvilluar intervistat e kandidatëve për pozitën e gjyqtarit në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Nga gjithsej, trembëdhjetë (13) kandidatët gjyqtar, tre (3) kandidatë - gjyqtarë kanë paraqitur dorëheqjen, ndërsa një (1) kandidat nuk është paraqitur në intervistë.

KGjK, më datë 06.08. 2020, ka marrë Vendim KGjK. Nr. 183/2020, dhe caktoi Komisionin për Rishqyrtim të ankesave të kandidatëve për ngritje në detyrë. Komisioni për Rishqyrtim i Këshillit, në afat të paraparë ka pranuar tri (3) ankesa të paraqitura kundër Panelit për shqyrtimin e aplikacioneve dhe intervistim. Komisioni për Rishqyrtim me datë 18.08.2020 dhe 20.08.2020 ka mbajtur takimin i cili ka vazhduar edhe me datë 07.09.2020.

Për pozitën gjyqtar të Gjykatës Supreme të Kosovës, që sipas konkursit kërkohen tri (3) pozita, nga të cilat njëra e rezervuar për minoritete, Paneli për Shqyrtimin e Aplikacioneve për këtë

konkurs rekomandon dy (2) kandidatë dhe me miratimin e anëtarëve të KGJK, emërohen për pozitat e sipër cekura.

Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit – Departamenti Special

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 23 qershor 2020, mori vendim, KGJK. nr. 94/2020, për shpalljen e konkursit të brendshëm për nëntë (9) pozita të lira për gjyqtarë, të cilët do të ushtrojnë funksionin e tyre në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit. Konkursi u shpallë me datë 2 korrik 2020.

Për Gjykatën Themelore – Departamentin Special, me konkurs janë shpallur gjashtë (6) pozita prej të cilave një (1) pozitë nga radhët e komuniteteve, ndërsa për Gjykatën e Apelit – Departamenti Special, me konkurs janë shpallur tri (3) pozita.

Pas mbylljes së konkursit Komisioni ka pranuar gjithsej njëzet e tri (23) aplikacione për pozitat gjyqtarë në Departamentin Special, nga të cilët dhjetë (10) kandidatë kanë aplikuar në Gjykatën Themelore, kurse njëmbëdhjetë (11) kandidatë kanë aplikuar për pozitat gjyqtarë Departamenti Special Gjykata e Apelit, ndërsa dy (2) kandidatë kanë aplikuar për të dy pozitat Gjykatë Themelore dhe Gjykatës së Apelit, Departamenti Special. Gjatë këtij procesi, dorëheqje kanë paraqitur dy (2) kandidatë (për arsye personale), ndërsa një (1) kandidat ka aplikuar pas afatit të paraparë me konkurs. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka pranuar një (1) ankesë, e cila është shqyrtuar në mbledhjen e 240-të, të mbajtur me datë 26 tetor 2020, dhe ka nxjerr Vendim KGJK. Nr.241/2020, për refuzimin.

Komisioni për Përzgjedhjen e Gjyqtarëve të Departamentit Special bazuar në Rregullore, ka bërë vlerësimin përfundimtar të kandidatëve duke përllogaritur pikët e dhëna nga secili anëtar i Komisionit. Gjatë vlerësimit dhe poentimit, Komisioni ka përdorur tabelën (formularin e pikëve) standarde të vlerësimit. Kandidatët janë listuar duke u bazuar në totalin e pikëve të fituara në pajtim me nenin 10, të Rregullores së KGJK-së, nr. 03/2019.

Bazuar në këtë Rregullore, kandidatët e pakënaqur pas vlerësimit përfundimtar të tyre nga ana e Komisionit dhe njoftimit mbi rezultatet, kanë pasur të drejtë të paraqesin kundërshtim në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Këtë të drejtë e kanë shfrytëzuar gjithsej dy (2) kandidatë - gjyqtarë.

Brenda afatit të përcaktuar me Rregullore, KGJK ka marrë vendim lidhur me kundërshtimet e paraqitura të kandidatëve, nga gjithsej dy (2) kundërshtime, KGJK vlerëson se në të gjitha rastet Komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë ka vepruar drejt komfor ligjit dhe rregullores në fuqi.

Pasi që Komisioni për përzgjedhjen e gjyqtarëve në Departamentin Special e ka prezantuar listën përfundimtare të kandidatëve me rekomandime, KGJK ka votuar për secilin kandidatë të rekomanduar nga ana e Komisionit dhe rezulton se në kuadër të Departamentit Special në Gjykatën Themelore në Prishtinë janë përzgjedhur gjashtë (6) gjyqtarë. Kurse në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës së Apelit janë përzgjedhur tre (3) gjyqtarë.

Konkursi për Kryetar të Gjykatës Themelore në Pejë

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 25 tetor 2019, ka marrë Vendim KGJK. Nr. 219/2019 për shpalljen e konkursit për pozitën Kryetar në Gjykatën Themelore në Pejë. Konkursi i brendshëm për kryetar të gjykatës Themelore në Pejë është shpallur më 28 janar 2020.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 21 shkurt 2020, ka marrë Vendim KGJK. Nr. 41/2020, dhe caktoi Komisionin Vlerësues për Intervistimin, Vlerësimin dhe Rekomandimin e kandidatëve, në bazë të Rregullores 09/2016, për Procedurën e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, të plotësuar përmes Rregullores Nr. 14/2016. Për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, Komisioni Vlerësues për Intervistim i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka pranuar vetëm një aplikacion (kandidatë) që ka aplikuar këtë pozitë.

Komisioni Vlerësues për Intervistim, Vlerësim dhe Rekomandim i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, konstaton se i intervistuari gjyqtar për Kryetar të Gjykatës Themelore në Pejë u tregua i suksesshëm në intervistën e dhënë para Komisionit, prandaj të njëjtin e ka rekomanduar për këtë pozitë.

Konkursi për Kryetar të Gjykatës Themelore në Gjakovë

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 25 tetor 2019, ka marrë Vendim KGjK. Nr. 218/2019, për shpalljen e konkursit për pozitën Kryetar në Gjykatën Themelore në Gjakovë. Konkursi i brendshëm për kryetar të Gjykatës Themelore në Gjakovë është shpallur më 28 janar 2020.

Më datë 21 shkurt 2020, Këshilli ka marrë Vendim, Nr. 42/2020, dhe caktoi Komisionin Vlerësues për Intervistimin, Vlerësimin dhe Rekomandimin e kandidatëve, në bazë të Rregullores 09/2016 për Procedurën e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, të plotësuar përmes Rregullores Nr. 14/2016, i cili do të informoj Këshillin Gjyqësor të Kosovës për rrjedhojën e procesit.

Me datë 25.06.2020, pas përfundimit të Vlerësimit të Performancës janë zhvilluar intervistat e kandidatëve për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë.

Për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Komisioni Vlerësues për Intervistim i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka pranuar vetëm një aplikacion (kandidatë) që ka aplikuar këtë pozitë. Komisioni Vlerësues për Intervistim, Vlerësim dhe Rekomandim i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, konstaton se i intervistuari gjyqtar për Kryetar të Gjykatës Themelore në Gjakovë u tregua i suksesshëm në intervistën e dhënë para Komisionit, prandaj të njëjtin e ka rekomanduar për këtë pozitë.

Procese të verifikuara sipas kërkesave të Institucioneve në marrëveshje me KGJK-në

Zyra për Vlerësim dhe Verifikim Gjyqësor, gjithashtu, i është përgjigjur edhe kërkesave të institucioneve tjera të Republikës së Kosovës me qëllim të mbledhjes së informatave në Gjykatat Themelore për verifikimin e të kaluarës së kandidatëve të tyre. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës me datë 02.06.2020, i është drejtuar KGJK-së me kërkesë për verifikimin e të kaluarës të kandidatëve për pjesëtarë të FSK-së. Policia e Kosovës më datë 29.01.2020 dhe 23.10.2020, i është drejtuar KGJK-së me kërkesë për verifikimin e të kaluarës për treqind e një (301) kandidatë, për pjesëtarë në PK.

8.0 BUXHETI I KËSHILLIT GJYQËSOR

8.1 Buxheti, shpenzimet dhe të hyrat gjyqësore

Buxheti fillestar i KGjK-së si organizatë buxhetore dhe dymbëdhjetë (11) programet e tij: Sekretariati i KGjK, Njësia për Shqyrtimin e Performancës Gjyqësore, Gjykata Supreme dhe Dhoma e Posaçme, Gjykata e Apelit, Gjykata Themelore Prishtinë, Gjykata Themelore Prizren, Gjykata Themelore Gjilan, Gjykata Themelore Ferizaj, Gjykata Themelore Pejë, Gjykata Themelore Gjakovë, Gjykata Themelore Mitrovicë për vitin 2020 sipas Ligjit Nr.07/L-001 për “Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020” është 29,821,540€ (me të hyra, pa donacione), për gjithsej 2,113 pozita prej tyre 452 gjyqtarë dhe 1,661 pozita administrative.

8.2 Ndryshimet buxhetore janar - dhjetor 2020

Pas rishikimit të buxhetit sipas Ligjit nr. 07/L-014, buxheti i Këshillit ka qenë 28,375.451.00€, ku sipas ligjit të rishikuar kemi zvogëlim të buxhetit në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve prej 511,500.00€, në kategorinë e shpenzimeve komunale kemi zvogëlim prej 157,065.00 si dhe në kategorinë e Shpenzimeve Kapitale kemi zvogëlim prej 777,524.00€.

Sipas vendimit të Qeverisë nr. 01/46 të datës 25.11.2020 në kategorinë Mallra dhe Shërbime, janë bërë shkurtime buxhetore në vlerë prej 208,579.62€, konkretisht buxheti i programit buxhetor të SKGjK-së (33300) është zvogëluar për 152,365.48€ dhe programit buxhetor të Gj.Th. Mitrovicë (38700) për 56,214.14€. Këto shkurtime janë bërë pa kërkesë apo pëlqim të KGjK-së.

Gjithashtu, sipas të njëjtit vendim, në emër të kursimeve kategoria e Shpenzimeve kapitale është shkurtuar për 160,000.00€. Ky shkurtim buxhetor është bërë pa pëlqimin e KGjK-së, paraprakisht, Këshilli përmes shkresës drejtuar MF, ka kërkuar që 150,000.00€ komfor Marrëveshjes së Mirëkuptimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) për bashkëfinancim

të projektit "Përpunimi i fasadës strukturale me hapje në kompleksin e Pallatit të Drejtësisë" të transferohen në buxhetin e MPB-së.

Me vendim të Qeverisë nr. 09/50 të datës 21.12.2020 në kategorinë e Shpenzimeve Komunale, janë bërë shkurtime buxhetore në vlerë prej 11,009.57€, konkretisht buxheti i programit buxhetor të SKGjK-së (33300) është zvogëluar për 3,365.51€, buxheti i programit buxhetor të Gj.Th. Mitrovicë (38700) është zvogëluar për 5,144.06€ dhe buxheti i Gj.Th. Gjakovë (38600) është zvogëluar për 2,500.00€. Gjithashtu, sipas të njëjtit vendim me kërkesë të KGjK-së, buxheti i Gj.Th. Prishtinë (38100) në kategorinë e Shpenzimeve Komunale është rritur për 7,000.00€. Me këtë vendim kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve është zvogëluar për 127,723.45€.

Për kursimet në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve, KGjK ka dërguar një shkresë për kursime sipas programeve buxhetore, por shuma e buxhetit të shkurtuar sipas këtij vendimi është më e madhe sesa kërkesa e KGjK-së. Me këtë vendim në kategorinë e pagave dhe mëditjeve janë bërë disa harmonizime ndërmjet programeve buxhetore të KGjK-së dhe në total kategoria e pagave dhe mëditjeve me këtë vendim është rritur, për 83,342.35€.

Këshilli ka pasur donacione në shumë prej 61,617.06€ nga UNDP dhe GIZ, kryesisht për mbështetje të stafit administrativ në disa gjykata (Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit, Gj.Th. Prishtinë, Gj.Th.Mitrovicë) dhe SKGjK. Të hyrat e bartura nga viti 2019 janë të hyrat në kategorinë e pagave dhe mëditjeve në shumë prej 22,585.00€ dhe shuma prej 43,185.59€ në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve. Buxheti përfundimtar (final) i KGjK-së, për vitin 2020 me të hyrat dhe donacione është **28,085,668.15€**.

8.3 Buxheti dhe shpenzimet 2020

Në tabelën nr.I është paraqitur buxheti fillestar, buxheti final, buxheti i zotuar si dhe realizimi i buxhetit të Këshillit sipas kategorive ekonomike.

Kategoritë ekonomike	Buxheti fillestar 2020	Buxheti Final 2020	Buxheti i zotuar	Buxheti zotuar %	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i shpenzuar %
Paga dhe mëditje	23,549,021.00	23,654,948.36	23,257,862.36	98.32	23,257,862.36	98.32
Mallra dhe shërbime	4,013,569.00	3,157,065.93	3,066,067.44	97.12	2,900,350.34	91.87
Shpenzime komunale	448,950.00	296,575.21	292,793.23	98.72	287,388.67	96.90
Subvencione dhe transfere	500,000.00	543,185.59	243,650.00	44.86	243,650.00	44.86
Shpenzime kapitale	1,310,000.00	372,276.00	372,275.99	100.00	347,844.61	93.44
Donacione		61,617.06	43,412.35	70.46	43,412.35	70.46
Totali	29,821,540.00	28,085,668.15	27,276,061.37	97.12	27,080,508.33	96.42

Tabela I. Buxheti dhe Shpenzimet e KGjK-së

Sipas figurës në vijim, pasqyrohet realizimi i buxhetit të Këshillit në përqindje (%) për secilën kategori ekonomike.




Figura I. Realizimi i buxhetit në %

Siç shihet në tabelën nr.1 dhe në figurën nr.1, buxheti i përgjithshëm i Këshillit prej **28,085,668.15€** në vitin 2020 është zotuar në shumën prej **27,276,061.37€**, shprehur në përqindje **97.12 %**, ndërsa është shpenzuar **27,080,508.33€**, shprehur në përqindje **96.42 %**.

Sipas kategorive ekonomike buxheti përgjithshëm i KGjK është zotuar dhe shpenzuar si në vijim:

- **Paga dhe Mëditje:** Nga shuma vjetore e buxhetit prej 23,654,948.36€ janë zotuar dhe shpenzuar 23,257,862.36€, shprehur në përqindje 98.32 %;
- **Mallra dhe Shërbime:** Nga shuma vjetore e buxhetit prej 3,157,065.93€ janë zotuar 3,066,067.44€ shprehur në përqindje 97.12 %, ndërsa janë shpenzuar 2,900,350.34€, shprehur në përqindje 91.87 %;
- **Shpenzimet Komunale:** Nga shuma vjetore e buxhetit prej 296,575.21€ janë zotuar 292,793.23€ shprehur në përqindje 98.72 %, ndërsa janë shpenzuar 287,388.67€, shprehur në përqindje 96.90 %;
- **Subvencione dhe transfere:** Nga shuma vjetore e buxhetit nga kjo kategori për transfere prej 543,185.59€ janë zotuar dhe shpenzuar 243,650.00€ shprehur në përqindje 44.86 %;
- **Shpenzimet Kapitale:** Nga shuma vjetore e buxhetit 372,276.00€ janë zotuar 372,275.99€ shprehur në përqindje 100.00 %, ndërsa janë shpenzuar 347,844.61€, shprehur në përqindje 93.44 %;

Sqarim: Në donacione shuma e përgjithshme prej 61,617.06€ janë nga UNDP (46,657.90€) dhe GIZ (14,429.84€) kryesisht për mbështetje të stafit administrativ në disa gjykatat e Kosovës (Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit, GjTh. Prishtinë, Gj.Th. Mitrovicë dhe SKGjK), ndërsa shuma 529.32€ e cila figuron në SIMFK është e bartur nga vitet paraprake.

Në tabelën nr.2 është paraqitur buxheti fillestar, buxheti final, buxheti i zotuar si dhe realizimi i buxhetit të Këshillit sipas programeve buxhetore.

Kategoritë ekonomike	Buxheti fillestar 2020	Buxheti Final 2020	Buxheti i zotuar	Buxheti i zotuar %	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i shpenzuar %
Sekretariati i KGJK-së	5,420,825.00	3,384,059.00	3,061,162.05	90.46	2,881,281.32	85.14
NjShPGj	135,438.00	115,265.81	111,543.55	96.77	111,523.28	96.75
Gjykata Supreme dhe Dhoma e Posaçme	1,650,325.00	1,656,499.70	1,626,581.60	98.19	1,626,581.60	98.19
Gjykata e Apelit	2,082,588.00	2,254,849.59	2,228,777.57	98.84	2,228,695.21	98.84
Gjykata Themelore Prishtinë	5,792,551.00	6,364,802.13	6,264,386.16	98.42	6,253,698.57	98.25
Gjykata Themelore Prizren	2,487,889.00	2,475,560.41	2,427,672.96	98.07	2,427,166.36	98.05
Gjykata Themelore Gjilan	2,488,661.00	2,478,974.44	2,419,534.75	97.60	2,418,684.31	97.57
Gjykata Themelore Ferizaj	1,888,076.00	1,935,748.78	1,887,423.82	97.50	1,887,051.18	97.48
Gjykata Themelore Pejë	2,534,187.00	2,376,947.15	2,328,027.63	97.94	2,325,962.82	97.86
Gjykata Themelore Gjakovë	1,791,455.00	1,672,247.60	1,626,316.22	97.25	1,625,958.61	97.23
Gjykata Themelore Mitrovicë	3,549,545.00	3,370,713.54	3,294,635.06	97.74	3,293,905.07	97.72
Totali	29,821,540.00	28,085,668.15	27,276,061.37	97.12	27,080,508.33	96.42

Tabela 2. Buxheti dhe Shpenzimet sipas programeve buxhetore të KGJK-së 2020

Sipas figurës në vijim, pasqyrohet realizimi i buxhetit në përqindje (%) për secilin program buxhetor të Këshillit.




Figura 2. Realizimi i Buxhetit sipas Programeve Buxhetore në %

Siç shihet në tabelën nr.2 dhe figurën nr.2, sipas programeve, buxheti i Këshillit është shpenzuar si në vijim:

Buxheti për programin e Sekretariatit të KGJK:

Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 90.46 %, ndërsa është shpenzuar 85.14 %.

Buxheti për programin e Njesisë për Shqyrtimin e Performancës Gjyqësore:

Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 96.77 %, ndërsa është shpenzuar 96.75 %.

Buxheti për programin e Gjykatës Supreme dhe Dhomës së Posaçme:

Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 98.19 %, ndërsa është shpenzuar 98.19%.

Buxheti për programin e Gjykatës së Apelit Prishtinë:

Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 98.84 %, ndërsa është shpenzuar 98.84%.

Buxheti për programin e Gj.Th. Prishtinë:

Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 98.42 %, ndërsa është shpenzuar 98.25 %.

Buxheti për programin e Gj.Th. Prizren:

Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 98.07 %, ndërsa është shpenzuar 98.05 %.

Buxheti për programin e Gj.Th. Gjiilan:

Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 97.60 %, ndërsa është shpenzuar 97.57% .

Buxheti për programin e Gj.Th. Ferizaj:

Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 97.50%, ndërsa është shpenzuar 97.48 %.

Buxheti për programin e Gj.Th. Pejë:

Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 97.94 %, ndërsa është shpenzuar 97.86%.

Buxheti për programin e Gj.Th. Gjakovë:

Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 97.25 %, ndërsa është shpenzuar 97.23 %.

Buxheti për programin e Gj.Th. Mitrovicë:

Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 97.74 %, ndërsa është shpenzuar 97.72%.

Të hyrat gjyqësore

Të hyrat gjyqësore të gjeneruara nga Këshilli, përkatësisht nga gjykatat dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme në vitin 2020 janë gjithsej: **6,043,052.00 €**.

Realizimit i të hyrave gjyqësore është **87.46%** në krahasim me planifikimin për vitin 2020 (6,910.000.00€). Në krahasim me vitin 2019, kemi rënie të inkasimit të hyrave për shkak të pandemisë COVID-19.

Në tabelën nr.3 janë paraqitur të hyrat gjyqësore sipas llojit, shumës dhe pjesëmarrjes në përqindje.

Lloji i të hyrave	Shuma sipas llojit	Pjesëmarrja në %
Taksat e Gjykatës - 50021	2,274,807.34	37.64
Gjobat e Trafikut - 50101	471,409.96	7.80
Gjobat e Gjykatës - 50102	3,150,822.70	52.14
Taksë për Kompensimin e Viktimave të Krimin - 50019	145,531.00	2.41
Të hyrat nga viti i kaluar - 61000	481.00	0.01
TOTALI	6,043,052.00	100%

Tabela 3. Të hyrat gjyqësore Janar - Dhjetor 2020

Sipas figurës nr.3 në vijim, pasqyrohet pjesëmarrja e të hyrave gjyqësore në përqindje (%).




Figura 3. Pjesëmarrja në %

9.0 ANALIZA E STATISTIKAVE VJETORE të KGJK-së 2020


Raporti Vjetor i KGJK-së me statistika të vitit 2020, është mbështetur në statistikat e mbledhura dhe të gjeneruara nga Sistemi i Informacionit të Menaxhimit të Lëndëve (SMIL). Kjo është një arritje e madhe për gjykatat dhe KGJK-në pasi që statistikat tani mund të gjenerohen automatikisht dhe shpejtë. Bazuar në Raportin Vjetor të KGJK-së, analiza aktuale është përgatitur, duke krahasuar statistikat e gjykatave në vitin 2019 me statistikat e gjykatave në vitin 2020. Është thelbësore të vlerësohet një analizë e tillë e statistikave për herë të parë, sidomos në funksion të krizës që ka sjellë pandemia COVID-19, duke pasur parasysh se sa kjo pandemi ka prekur sistemin gjyqësor në vend.

Kjo analizë, shikon numrin e lëndëve në hyrje, lëndët e zgjidhura dhe lëndët të pazgjidhura për kategoritë kryesore të lëndëve: lëndët penale në Departamentin e Përgjithshëm, krimet e rënda në Departamentin e Krimeve të Rënda, lëndët civile, lëndët administrative, lëndët ekonomike dhe kundërvajtje. Objektivi është të shohim nëse gjykatat kanë pranuar më shumë, ose më pak lëndë sesa në vitin 2019; nëse gjykatat kanë zgjidhur më shumë, ose më pak lëndë sesa në vitin 2019; dhe nëse numri i lëndëve të pazgjidhura po rritet, apo zvogëlohet. Analiza, ofron një krahasim të statistikave midis gjykatave. Në këtë mënyrë, është e mundur të shihet, për shembull, nëse numri i lëndëve të pranuar është rritur vetëm në një gjykatë, ose në disa gjykata. Gjithashtu, kjo analizë fokusohet në moshën e lëndëve të pazgjidhura. Ky tregues do të ndihmojë për të monitoruar nëse lëndët më të vjetra zgjidhen në fillim.

Statistikat (për të gjitha gjykatat themelore të mbledhura së bashku) tregojnë se përkundër situatës së vështirë për shkak të pandemisë, ata kanë zgjidhur më shumë lëndë të krimeve të rënda në vitin 2020 sesa në vitin 2019. Gjykatat themelore kanë zgjidhur më shumë lëndë civile në vitin 2020. Sidoqoftë, numri i lëndëve është rritur në këto dy kategori të lëndëve sepse gjykatat themelore morën më shumë nga ato lëndë në vitin 2020. Rritja është e konsiderueshme për lëndët civile: 16488 lëndë shtesë të pazgjidhura në 2020. Në Departamentin e Përgjithshëm, gjykatat

zgjidhën më pak lëndë penale sesa në 2019, por kanë pranuar një numër më të vogël të këtyre rasteve. Në Prishtinë, në Departamentin për lëndë Tregtare, gjendja ishte tashmë e vështirë në 2019, u përkeqësua në vitin 2020 (*Norma e Zgjidhjes së Lëndëve: nga 86% në 2019 në 79% në 2020*). Si rezultat, numri i lëndëve ekonomike të pazgjidhura është rritur. Përkundrazi, në Departamentin Administrativ, situata u përmirësua (*Norma e Zgjidhjes së Lëndëve: nga 93% në 2019 në 102% në 2020*). Sidoqoftë, duhet të theksohet se numri i lëndëve administrative në hyrje në vitin 2020, ishte shumë më i ulët në vitin 2020. Së fundi, tabelat mbi moshën e lëndëve të pazgjidhura tregojnë se, ekziston një numër i lartë i lëndëve më të vjetra se tri (3) vite të cilat janë të pazgjidhura në Departamentin e Krimeve të Rënda në Mitrovicë dhe në divizionin civil në Prishtinë.

GJITHSEJ GJYKATAT THEMELORE



Departamenti i Përgjithshëm, lëndët penale

- Departamenti i Përgjithshëm ka pranuar më pak lëndë penale në vitin 2020, sesa në vitin 2019.
- Departamenti i Përgjithshëm ka zgjidhur më pak lëndë penale në vitin 2020, sesa në vitin 2019.
- Në vitin 2020, Departamenti i Përgjithshëm ka zgjidhur më shumë lëndë penale, sesa kishte pranuar. Si rezultat, Norma e Zgjidhjes së Lëndëve (CR = Clearance Rate) është e mirë: 107%. Sidoqoftë, siç u shpjegua më lart, Departamenti i Përgjithshëm pranoi një numër mjaft të ulët lëndësh dhe ka zgjidhur më pak raste, sesa në vitin 2019.

Departamenti i Krimeve të Rënda


- Departamenti i Krimeve të Rënda ka pranuar më shumë lëndë në vitin 2020, sesa në vitin 2019.
- Departamenti i Krimeve të Rënda ka zgjidhur më shumë raste në 2020, sesa në 2019.
- Në vitin 2020, Departamenti i Krimeve të Rëndës ka zgjidhur më shumë lëndë penale sesa kishte pranuar. Si rezultat, Norma e Zgjidhjes së Lëndëve (CR = Clearance Rate) është e mirë.

Departamenti i Përgjithshëm, lëndët civile (të kontestuara)

- Departamenti i Përgjithshëm ka pranuar më shumë lëndë civile në vitin 2020, sesa në vitin 2019.
- Departamenti i Përgjithshëm ka zgjidhur rreth të njëjtit numër lëndësh në vitin 2020 dhe në vitin 2019.
- Në vitin 2020, Departamenti i Përgjithshëm nuk ishte në gjendje të zgjidhte numrin e lëndëve që pranoi. Si rezultat, Norma e Zgjidhjes së Lëndëve është nën 100% (është jashtëzakonisht e ulët: 69%). E njëjta situatë ndodhi edhe në vitin 2019, Departamenti i Përgjithshëm nuk ishte në gjendje të zgjidhte numrin e lëndëve që kishte pranuar.

Divizioni për Kundërvajtje

- Divizioni për Kundërvajtje ka pranuar të njëjtin numër të lëndëve në vitin 2020 dhe në vitin 2019.
- Divizioni për Kundërvajtje ka zgjidhur shumë më pak raste në vitin 2020, sesa në vitin 2019.
- Në vitin 2020, Divizioni për Kundërvajtje ka zgjidhur shumë më pak raste, sesa kishte pranuar. Si rezultat, Norma e Zgjidhjes së Lëndëve është nën 100% (dhe është jashtëzakonisht e ulët).



Departamenti i Përgjithshëm, lëndët penale

- Numri i lëndëve të pazgjidhura në Departamentin e Përgjithshëm është rritur pak.

Departamenti i Krimeve të Rënda

- Numri i lëndëve të krimeve të rënda të pazgjidhura në Departamentin e Krimeve të Rënda është rritur.

Departamenti i Përgjithshëm, lëndët civile (të kontestuara)

- Numri i lëndëve civile të pazgjidhura në Departamentin e Përgjithshëm është rritur shumë.


Divizioni për Kundërvajtje

- Numri i kundërvajtjeve të pazgjidhura është ulur.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Ngarkesa me lëndë

Grafiku I:



Grafiku I tregon sa vijon:

Departamenti i Përgjithshëm, lëndët penale

- Departamenti i Përgjithshëm ka pranuar shumë më pak lëndë penale në vitin 2020, sesa në vitin 2019.
- Departamenti i Përgjithshëm ka zgjidhur më pak lëndë penale në vitin 2020, sesa në vitin 2019.
- Në vitin 2020, Departamenti i Përgjithshëm ka zgjidhur më shumë lëndë penale, sesa kishte pranuar. Si rezultat, Norma e Zgjidhjes së Lëndëve (CR = Clearance Rate) është e mirë: 122%. Sidoqoftë, siç

u shpjegua më lart, Departamenti i Përgjithshëm pranoi një numër mjaft të ulët lëndësh dhe ka zgjidhur më pak raste, sesa në vitin 2019.

Departamenti i Krimeve të Rënda

- Departamenti i Krimeve të Rënda ka marrë më shumë lëndë në vitin 2020, sesa në vitin 2019.
- Departamenti i Krimeve të Rënda ka zgjidhur më shumë raste në vitin 2020, sesa në vitin 2019.
- Në vitin 2020, Departamenti i Krimeve të Rënda ka zgjidhur më shumë lëndë, sesa kishte pranuar. Si rezultat, Norma e Zgjidhjes së Lëndëve është nën 100%.

